



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 12.11.2014; ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore për Progresraportin 2014 me prokurorin e Përgjithshëm
2. Seancë dëgjimore për Progresraportin 2014 me Avokatin e Popullit
3. Projektligji “Për faljen e kamatëvonesave dhe gjobave për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi”
4. Diskutim i Projektbuxhetit 2015 për Ministrinë e Drejtësisë.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Nard Ndoka, Silva Caka dhe Tahir Muhedini.

Mungojnë:

Edi Paloka, Kastriot Islami, Armando Prenga, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Mhill Fufi, Mark Frroku, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Tom Doshi, Pirro Lutaj dhe Eduard Halimi.

Të ftuar:

Adriatik Llalla – prokuror i Përgjithshëm

Fjorida Ballauri – drejtore e Kabinetit të Prokurorit të Përgjithshëm

Alban Serani – këshilltar i Prokurorit të Përgjithshëm
Igli Totozani - Avokati i Popullit
Etilda Gjonaj - komisionere
Arben Shkëmbi - komisioner
Ermir Kapedani - komisioner
Bardhylka Kospiri – zëvendësministre, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
Enkelejd Musabelli - këshilltar i Ministrit
Astrit Kuka - drejtor i Sigurimeve Shoqërore dhe Pagave pranë MMSR
Ali Emini - drejtor pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore
Nasip Naço – ministër i Drejtësisë
Llambriola Misto – sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë
Petrut Baku – drejtor
Qauser Rama – përgjegjës Sektori
Erjon Luçi – zëvendësministër i Financave
Gelardina Prodani – sekretare e Përgjithshme
Mimoza Dhëmbi – drejtore e Përgjithshme e Buxhetit
Fran Brahimi – Drejtoria e Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mund të fillojmë mbledhjen e Komisionit.

Siç jeni tashmë në dijeni, kemi pasur një sërë seancash dëgjimore me përfaqësues të qeverisë, ministra të kabinetit qeveritar dhe institucione të pavarura, që janë pjesë e fushës së përgjegjësisë që mbulon Komisioni i Çështjeve ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, në reflektim të rekomandimeve të Progresraportit 2014, rekomandime që janë tejet të rëndësishme për vendin, për procesin e integritetit të plotë të vendit në BE, ndaj të cilave kemi të gjithë përgjegjësi, duke filluar nga Kuvendi, qeveria, institucionet e pavarura, për të mundësuar hapa më të shpejtë dhe më të qëndrueshëm, në kuadër të procesit të plotë të integritetit të Shqipërisë në BE. Për shkak se Prokurori i Përgjithshëm, për arsye objektive, ka pasur disa angazhime të rëndësishme në ushtrimin e profesionit të tij. Nuk është bërë e mundur që të zhvillohej kjo seancë dëgjimore javën e mëparshme, kështu që do të jemi të detyruar për ta zhvilluar sot. Do të jetë një ditë e ngjeshur, sepse në kalendar ka hyrë edhe buxheti i shtetit.

Do t'u kërkoja kolegëve dhe medias durimin e nevojshëm, sepse që të dyja janë të rëndësishme, edhe Progresraporti, rekomandimet dhe reflektimet, edhe projektbuxheti, për shkak se të dyja janë ndjeshmëri në jetën e këtij vendi.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, seancën dëgjimore për Progresraportin 2014. Është i ftuar Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, zoti Adriatik Llalla.

Faleminderit, zoti Prokuror, që jeni i pranishëm! Shpresoj që të paraqisni në mënyrë të përmbledhur se cilat janë reflektimet e institucionit tuaj ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve që ka bërë Progresraporti. Pastaj të dëgjojmë pyetjet e deputetëve në këtë kontekst. E ritheksoj, është një fakt i njohur, por gjithsesi e kam për detyrë ta sjellë në vëmendjen e kolegëve dhe të medias, Prokurori i Përgjithshëm nuk është sot për raportin vjetor të tij, as për ndonjë lloj raportimi tjetër të caktuar sipas Kushtetutës, ligjit apo rezolutave të Kuvendit, por thjesht e vetëm për Progresraportin. Natyrisht, si në çdo rast tjetër, nuk duhet t'i përgjigjet asnjë pyetjeje që lidhet me çështje konkrete. Nuk ndodh, por unë jam i detyruar ta bëj këtë paralajmërim edhe për kolegët, edhe për median, që zakonisht ka qejf të merret më shumë me këto çështje, sesa me atë që është realisht e rëndësishme, që ka të bëjë me mënyrën se si do t'i qasemi në atyre sugjerimeve, rekomandimeve dhe kritikave të Progresraportit.

Zoti Prokuror i Përgjithshëm, fjala për ju.

Adriatik Llalla – I nderuar Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Prokuroria Shqiptare vijon të jetë e angazhuar maksimalisht në plotësimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian. Fokusi ynë është përqendruar në tri momente kryesore: reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit dhe lufta kundër krimit të organizuar.

Prokuroria Shqiptare është pjesë e aktive e reformës në Drejtësi. Në vlerësimin e institucionit, kjo reformë duhet nisur fillimisht nga evidentimi i problemeve. Në bazë të tyre, të ndërtohet një strukturë solide që do t'i shërbejë forcimit të pavarësisë, llogaridhënies, si edhe profesionalizimit në sistemin e drejtësisë.

Nga ana e saj, brenda hapësirës aktuale ligjore, prokuroria ka ndërmarrë masa konkrete në tri drejtimet e sipërcituara.

Në përmbushje të Prioritetit Nr. 2 të Udhërrëfyesit të Komisionit Evropian, Prokuroria ka miratuar disa masa për forcimin e rolit të Këshillit të Prokurorisë. Janë bërë disa ndryshime në Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Prokurorisë”, të cilat konsistojnë në zhvillimin e seancave dëgjimore nga Këshilli i Prokurorisë për rastet e konkurrimit për ngritje në detyrë apo për drejtues prokurorie krahas konkurrimit me dosje, ngritjen e Komisionit të Verifikimit të përmbushjes së kriterëve ligjore të kandidatëve, me pjesëmarrjen e dy anëtarëve të Këshillit dhe një punonjësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, si dhe ndryshime të tjera që synojnë t'i japin Këshillit një rol më aktiv në administrimin e prokurorisë.

Nga ana tjetër, Prokuroria e sheh me interes forcimin e rolit të Këshillit të Prokurorisë duke reflektuar ndryshimet e nevojshme ligjore. Ky organizëm duhet të ketë në vijim një rol më të rëndësishëm në promovimin e vlerave institucionale.

Gjithashtu, Prokuroria është fokusuar në rritjen e profesionalizmit të punonjësve. Veçojmë Projektin Rajonal IPA 2010 “Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve”. Në kuadër të këtij instrumenti të Bashkimit Evropian janë zhvilluar një sërë kursesh trajnimi për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore. Mbështetje të konsiderueshme në forcimin e kapaciteteve për luftën kundër krimit të organizuar dhe krimit ndërkombëtar kanë dhënë dhe vijojnë të japin projekti OPDAT dhe PAMECA.

Sa i përket kontrollit të brendshëm, krahas inspektimeve periodike që zhvillohen në prokurori të ndryshme, gjatë vitit 2014, është miratuar akti normativ “Rregulla mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”. Ky akt, i cili vjen në përmbushje edhe të rekomandimeve të GREKO-s, shërben për vlerësimin profesional dhe moral të prokurorëve. Gjithashtu, shërben

edhe për promovimin e vlerave dhe rritjen e përgjegjshmërisë në strukturën e Prokurorisë Shqiptare.

Po ashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka pasur aktivitet të shtuar për rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale. Në këtë kuadër, gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë qarkore të posaçme lidhur me zbatimin e unifikuar të ligjit për amnistinë; për unifikimin dhe ushtrimin me efikasitet të së drejtës së ankimit; si edhe për zbatimin e unifikuar të nenit 199/a të Kodit Penal për ndërtimet e paligjshme.

Lufta kundër korrupsionit vijon të jetë prioriteti madhor i prokurorisë shqiptare

Ka pasur një aktivitet të ngjeshur në këtë drejtim, sidomos sa u përket hetimeve për shpërdorimin e detyrës, që përbën numrin më të madh të procedimeve të regjistruara në këtë fushë. Prokuroria ka forcuar dhe konsoliduar aktivitetin e Njësive të Përbashkëta Hetimore, të cilat janë struktura të specializuara për hetimet në fushën e korrupsionit, krimit ekonomik, pastrimit të parave dhe krimit kibernetik. Si masa të rëndësishme përmendet ngritja e një njësie të tillë në prokurorinë e Elbasanit. Po ashtu, edhe njësitë e tjera janë mbështetur me rritje të numrit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

Me ndryshimet e fundit ligjore, sa i përket korrupsionit në nivele të larta, të gjyqtarëve, prokurorëve, ministrave, deputetëve, të zgjedhurve vendorë etj., kompetencë e kaluar Prokurorisë së Krimeve të Rënda, pranë së cilës është krijuar një njësi e specializuar.

Të gjitha këto njësi koordinohen nga Drejtoria për Hetimin kundër Korrupsionit në Prokurorinë e Përgjithshme. Kjo strukturë, e cila është krijuar në maj 2014 pranë Prokurorisë së Përgjithshme, po shërben për koordinimin dhe standardizimin e proceseve hetimore kundër korrupsionit.

Po ashtu, në drejtim të forcimit të kapaciteteve të këtyre njësive, janë kryer trajnime të shumta të prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore me Shkollën e Magjistraturës, si dhe me projekte të financuar nga donatorë të huaj.

Lufta kundër korrupsionit në përgjithësi dhe ai në sektorin publik në veçanti është forcuar gjatë vitit 2014. Treguesit statistikorë shprehin rritje me 46% të numrit të procedimeve të regjistruara për grupveprat penale të korrupsionit në sektorin publik dhe rritje me 49% të numrit të të pandehurve të regjistruar. Gjithashtu rritje kanë pësuar edhe numri i procedimeve dërguar gjyqit me 47% dhe numri i të pandehurve dërguar gjyqit me 39%.

Peshën më të madhe në këtë grup e ka vepra penale e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave me funksione publike”. Duke krahasuar të dhënat ndërmjet 9-mujorit 2013 dhe 9-mujorit 2014, konstatohen rritje e ndjeshme e aktivitetit për

këto grup-veprash. Kështu, ka rritje me 35% të procedimeve të regjistruara, si edhe rritje prej 29% sa u përket personave të dërguar për gjykim.

Gjatë 9-mujorit 2014 procedimet penale për shpërdorimin e detyrës janë rritur me 85% krahasuar me ato të 9 mujorit 2013. Procedimet e dërguara për gjykim janë rritur me 33%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Lidhur me veprat penale të korrupsionit në sistemin gjyqësor, gjatë 9-mujorit 2014 janë dërguar për gjykim disa punonjës të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë dy gjyqtarë, një prokuror, një kancelare dhe disa të tjerë në Pukë. Po ashtu, për veprën penale të fshehjes së pasurisë është regjistruar procedimi penal dhe po zhvillohen hetime për tre gjyqtarë të tjerë. Për këta tre gjyqtarë, prokuroria ka kërkuar masën e pezullimit nga detyra. Gjykata e shkallës së parë mbështeti kërkesën vetëm për njërin prej tyre, duke e pezulluar tre muaj nga detyra. Por, edhe kjo masë u rrëzua nga gjykata e Apelit.

Në grupin e veprave të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën dhe krijimit të skemave mashtruese, Prokuroria ka pasur angazhim të veçantë gjatë vitit 2014. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë hetuar dhe janë dërguar për gjykim kërkesat për rreth 90 shtetas dhe persona juridikë, të cilët i kanë shkaktuar shtetit dëm ekonomik që llogaritet në disa dhjetëra milionë euro.

Për të krijuar një historik solid rezultatesh, Prokuroria, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka mbajtur, koordinuar dhe raportuar të dhëna të hollësishme me bazë 3-mujore mbi hetime të kësaj natyre.

Po ashtu, janë shtuar ndjeshëm kontaktet me përfaqësues të institucioneve të përfshira në luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, si me policinë e shtetit, dogana, tatime, shërbimet inteligjente etj.

Pas një takimi të zhvilluar në maj 2014 ndërmjet drejtuesve të Prokurorisë dhe drejtuesve të Policisë, tashmë është krijuar një praktikës standarde për analizimin periodik për analizimin e rasteve konkrete. Në nivel qendror dhe në nivel lokal, çdo muaj zhvillohen diskutime mbi raste konkrete. Këto analiza periodike kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e forcës goditëse kundër korrupsionit dhe krimit në përgjithësi.

Forcimi i bashkëpunimit institucional ka dhënë rezultate konkrete edhe në rritjen e numrit të hetimeve proaktive.

Duhet të ndalemi veçanërisht në hetimin për pastrimin e produkteve të veprave penale. Konstatohet se ka pasur rritje në sekuestrim dhe konfiskim të pasurive të rrjedhura nga veprimtaritë kriminale. Gjithsesi, nisur nga të dhënat, rezulton se numri i procedimeve të

regjistruara ka pasur rritje, ndërsa numri i rasteve të dërguara për gjykim ka pasur ulje, krahasuar me një vit më parë.

Këto të dhëna kanë qenë objekt i analizës së Drejtorisë së Hetimit të Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit. Është konstatuar se problematika nis që në momentin e referimit të këtyre rasteve, në verifikimet paraprake dhe më pas në nevojën për veprime në një kohë relativisht të gjatë.

Për të rritur efektivitetin në këtë drejtim, Prokuroria është angazhuar në kontakte të vazhdueshme me Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe me Policinë e Shtetit për të trajtuar sipas parashikimeve ligjore çdo informacion të kësaj natyre. Nga ana tjetër, po në këtë drejtim, prokuroria po punon me të gjithë agjencitë e tjera që administrojnë regjistra publikë për të përfshirur në kohë reale të dhënat që përpunohen prej tyre. Është fakt se është gjetur mbështetja dhe impenjimi i të gjithë këtyre strukturave për të krijuar aksesin e prokurorisë në bazat e tyre të të dhënave.

Lufta kundër krimit të organizuar

Prokuroria ka vijuar të jetë e angazhuar në luftën kundër krimit të organizuar. Referuar treguesve statistikorë, për vepra penale të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, në 9-mujorin 2014 evidentohet rritje prej 31% e procedimeve penale të regjistruara, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në fokus të veçantë ka qenë lufta kundër kultivimit dhe trafikut të lëndëve narkotike. Rritja e ndjeshme e shifrave është rrjedhojë e operacioneve në Lazarat të Gjirokastrës, të shtrirë më pas në Dukagjin, Shkodër.

Në bashkëpunim me institucionet ligjzbatuese shqiptare, si edhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, u dha një kontribut i veçantë në luftën kundër personave që merren me rekrutimin dhe financimin e shtetasve për përfshirjen në konflikte të armatosura jashtë Europës. Në mars 2014 u zbuluan një grup personash që ishin të përfshirë në këtë vepër penale. Prej atij momenti, konstatohet se ka një stepje të këtij aktiviteti në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky angazhim i institucioneve shqiptare është vlerësuar pozitivisht edhe nga partnerët ndërkombëtarë.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, gjatë periudhës janar – tetor 2014 janë realizuar veprime për ekzekutimin e disa komisioneve rogatore të kërkuara nga autoritetet e Belgjikës, Francës, Norvegjisë etj., si kontrole banesash, verifikim pasurie, sekuestime të llogarive bankare etj. Theksojmë se këto veprime procedurale janë kryer nga Prokurorët e Prokurorisë për Krime të Rënda në Tiranë në praninë e përfaqësuesve të autoriteteve të huaja.

Ndërkohë, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, Prokurori i Përgjithshëm zhvilloi takime dhe bisedime me zyrtarë të Departamentit të Drejtësisë, Departamentit të Shtetit dhe agjencive të tjera në Uashington, krahas takimit me Prokurorin e Përgjithshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Po ashtu, një zhvillim shumë të rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, veçojmë Marrëveshjen e Bashkëpunimit të nënshkruar pak ditë më parë ndërmjet Prokurorisë Shqiptare dhe Drejtorisë së Antimafias së Italisë. Kjo marrëveshje zëvendëson një dokument të nënshkruar në vitin 1997 dhe parashikon mekanizma të rinj për luftën kundër krimit të organizuar dhe atij ndërkombëtar.

Për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit, ditën e sotme, prokuroria shqiptare do të presë edhe Prokurorin Federal të Mbretërisë së Belgjikës.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut ka vijuar të jetë një ndër prioritetet e organit të prokurorisë gjatë vitit 2014. Në këtë drejtim janë marrë disa masa dhe janë realizuar nisma konkrete. Është treguar një vëmendje e veçantë për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të miturve të përfshirë në procedime penale qoftë si të pandehur, persona nën hetim, të dëmtuar ose dëshmitarë.

Për sa i përket të drejtës për të jetuar, lidhur me fenomenin e gjakmarrjes të përmendur dhe në Progresraport, Prokuroria ka zhvilluar aktivitet specifik në drejtim të evidentimit dhe zbulimit të rasteve të gjakmarrjes.

Ka pasur një iniciativë konkrete nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Për një periudhë 5-mujore, kjo prokurori ka regjistruar familjet që janë në gjakmarrje, si edhe ka marrë deklaratimet e personave të ngjuar për shkak të këtij ligji të pashkruar. Nga të dhënat, rezulton se shifra e personave dhe e familjeve të ngjuara është shumë herë më e vogël sesa ajo që raportohet nga shoqata të ndryshme. Kështu, janë kontaktuar 200 familje, të cilat kanë qenë të përfshira në konflikt. Prej tyre, janë konstatuar në ngujim 25 familje me 30 persona gjithsej. Sipas kontakteve të drejtpërdrejta me personat e ngjuar, rezulton se ata nuk janë të kanosur drejtpërdrejt, por qëndrojnë të izoluar për shkak të frikës.

Këto të dhëna e kanë ndihmuar prokurorinë shqiptare të krijojë një panoramë të qartë mbi përhapjen e fenomenit dhe sidomos për të bashkëpunuar me autoritetet e huaja lidhur me kërkesat për azil. Autoritetet shqiptare janë përballur me shqetësimin e homologëve europianë lidhur me numrin në rritje të azilkërkuesve, të cilët paraqesin si shkak gjakmarrjen. Iniciativa e prokurorisë, e cila nisi nga Shkodra, është në vijim të bashkëpunimit me

autoritetet e huaja për të evidentuar personat që abuzojnë me lirinë e lëvizjes, duke kërkuar azil me dokumente të falsifikuara si të përfshirë në gjakmarrje.

Krahas aktivitetit konkret, ju bëjmë prezent edhe ecurinë e Sistemit të Menaxhimit të Rasteve, një projekt i financuar nga delegacioni i Bashkimit European dhe që ka për qëllim dixhitalizimin e të dhënave në prokurori.

Ky projekt ka kaluar tashmë fazën pilot dhe pritet të implementohet në fillim të vitit 2015. Sistemi, do të mundësojë gjenerimin në kohë reale punën dhe statistikave të prokurorisë.

Nëpërmjet tij do të jenë mundësitë që të përftohen të dhëna për procedimeve penale në çdo fazë të hetimi, çka përbën arritje të rëndësishme në punën e institucionit të prokurorisë, në përmbushje të Rekomandimeve të Komisionit European për krijimin e bazës së të dhënave.

Të nderuar deputetë, duke shprehur vlerësimin për mbështetjen e deritanishme, prokuroria ju prezanton edhe nevojat e saj lidhur me përmbushjen sa më të plotë të rekomandimeve të Bashkimit European.

Gjatë vitit 2014 dhe 2013 ka pasur një volum të madh pune, krahasuar me vitet e tjera, i cili është përballuar nga e njëjta trupë prokurorësh. Krahasuar me 9- mujin e vitit 2013, gjatë këtij viti kemi rritje prej 36% të procedimeve të regjistruara dhe 50% të numrit të pandehurve të regjistruar.

Ngarkesa dhe dinamika e punës së prokurorisë është rritur shumë nga viti në vit, po ashtu edhe kërkesat dhe pritshmëritë mbi rezultatet e hetimeve.

Progresraporti 2014 lidhur me efencën e sistemit të drejtësisë nënvizon se: “Burimet në dispozicion duhet të rishikohen dhe të shtohen, që të përballohet rritja e ngarkesës së punës në prokurori dhe gjykata”.

Rritja e shpejtësisë dhe efencës së ndjekjes penale, krahas masave të tjera, duhet të shoqërohet edhe me shtimin e numrit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Kërkesë të cilën Prokuroria e ka paraqitur para Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit.

Nga ana tjetër, Sistemi i Menaxhimit të Rasteve, zbatimi i të cilit është përfshirë në një ndër pikat dhe rekomandimet kryesore të 5 prioriteteve të Komisionit Evropian, rrezikon implementimin e tij për shkak të mosmiratimit të shtimit të numrit prej 20 punonjësish të IT. Aktualisht, në organikën e Prokurorisë së Përgjithshme janë vetëm 6 specialistë, të cilët e kanë të pamundur të mbulojnë dhe përballojnë ngarkesën e punës që do të sjellë implementimi i Sistemit të Menaxhimit të Rasteve.

Prokuroria Shqiptare e rithekson para këtij Komisioni nevojën për mbështetje në shtimin e burimeve njerëzore. Kjo nisur edhe nga fakti se tashmë është dorëzuar në Kuvend Projektbuxheti për vitin 2015 dhe kërkesat e prokurorisë në këtë drejtim nuk janë reflektuar.

Duke shpresuar në mbështetjen e këtij Komisioni, e vlerësojmë shumë të nevojshme rritjen e numrit të prokurorëve e të oficerëve të policisë gjyqësore, si edhe të stafit që do të menaxhojë sistemin dixhital, pasi në këtë mënyrë do të rritet më tej efektiviteti i prokurorisë shqiptare.

Të nderuar deputetë, në mënyrë të përmbledhur ju paraqitëm aktivitetin e prokurorisë në përmbushje të prioritetëve të Bashkimit Europian, si edhe nevojat konkrete të institucionit për rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Prokuror i Përgjithshëm, për ekspozenë dhe reflektimet që u keni bërë gjetjeve dhe rekomandimeve të Progresraportit! Natyrisht edhe për çështjet e tjera që u cekën nga ana juaj, të cilat kanë lidhje me Progresraportin, por që do të jenë pjesë edhe e debateve të tjera në këtë Komision, siç është buxheti, apo ecuria e kriminalitetit për vitin 2014. Gjithsesi, të gjitha mbeten çështje me interes dhe mbeten në vëmendje e këtij Komisioni, përfshirë edhe çështjen që ju ngritët në lidhje me buxhetin, që do të diskutohet në ditët në vijim.

Duke mbetur në fokus të gjetjeve dhe rekomandimeve të Progresraportit, si mbasi dëgjuam edhe zotin prokuror të Përgjithshëm me ekspozenë e paraqitur, kush ka pyetje nga kolegët deputetë?

Zoti Manja.

Pastaj zonja Hysi.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Në fakt, konstatimet e Progresraportit, por edhe të vetë Prokurorit të Përgjithshëm, qëndrojnë, sepse prokuroria është një institucion që ka problemet e veta, edhe për shkak se numri i prokurorëve apo i oficerëve ka ngelur ai që ka qenë, ndërkohë që numri i çështjeve ka ardhur duke u rritur. Përpos kësaj, unë kam një pyetje që i referohet saktësisht Progresraportit, sepse siç e thatë edhe ju, ne do të kemi rastin që të diskutojmë edhe Projektbuxhetin, por edhe raportimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

Zoti Prokuror, Progresraporti i vitit 2014, thotë që duhet të miratohen akte ligjore kyçe, për reformimin e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, KLD-së, si dhe Prokurorisë. Po ashtu, thotë që problem shqetësues ngelet mungesa e llogaridhënies së Prokurorisë së

Përgjithshme, si dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e personelit kyç në këtë institucion duhet të jenë më transparente e të paanshme. Si dhe duhet të rritet dhe të forcohet roli i Këshillit të Prokurorisë.

Zoti Prokuror, në kuadrin e reformës së drejtësisë penale, a ka Prokuroria e Përgjithshme një strategji të qartë se si duhet t'i adresojë këto tri konstatime apo shqetësime që ngre Progresraporti.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Manja!

Zoti Prokuror i Përgjithshëm.

Adriatik Llalla – Lidhur me pyetjen e zotit deputet, duhet të theksoj se Prokuroria e Përgjithshme ka qenë pjesë aktive e të gjitha tryezave ku është diskutuar lidhur me reformën në sistemin e drejtësisë. Për sa i përket pyetjes lidhur me reformimin e Këshillit të Prokurorisë, apo dhe të ligjit “Për Prokurorinë shqiptare”, do të theksoj se kemi marrë nismat e para në këtë drejtim, ashtu siç e përmenda edhe në fjalën time. Me rregulloren e re të miratuar së fundmi, procesi i Këshillit të Prokurorisë ka vijuar të bëhet edhe më tej transparent, ku procesi i emërimit, transferimeve, si çdo nismë tjetër që shqyrtohet në Këshillin e Prokurorisë, krahas shqyrtimit të dokumenteve dëgjohen edhe personat që do të konkurrojnë për një pozicion të caktuar, në transferime apo ngritje në detyrë etj.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Prokuror i Përgjithshëm!

Në Progresraport e BE-së vihet theksi te zvarritjet e procedimeve dhe çështjeve të prapambetura. Njëkohësisht, theksohet rritja e efencës për të bërë më proaktive hetimet në fushën financiare, konflikti interesit, deklarimi i pasurive etj.

Pyetja ime është: zvarritja e procedimeve dhe mungesa e hetimeve proaktive vijnë për shkak të numrit të pakët të prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore, apo ka arsye të tjera?

Pyetja e dytë ka të bëjë pikërisht me atë që thuhet në Progresraport lidhur me hetimin e çështjeve të korrupsionit. Në Progresraport thuhet se hetimet janë më shumë të nxitura sesa kryesisht. Sipas mendimit tua, cila është arsyeja që Prokuroria nuk është proaktive? Duke pasur parasysh përgjigjet e këtyre dy pyetjeve që adresova, do të vlerësoja shumë se cila janë propozimet tuaja lidhur me ndryshimet që duhen bërë në Kodin penal dhe

në Kodin e Procedurës Penale? Meqenëse Progresraporti rekomandon transpozimin e plotë të konventës së Palermos dhe të dy protokolleve shtesë. Meqenëse ne jemi Komision Ligjesh e kemi për detyrë të bëjmë miratimin e ligjeve, por edhe të japim propozime për buxhetin. A mund të më thoni se çfarë kërkon konkretisht në fushën e reformave legislative?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Zoti prokuror i Përgjithshëm, mund të përgjigjeni për pyetjet e koleges.

Adriatik Llalla – Në lidhje me pyetjen e parë, zonja Hysi e tha vetë përgjigjen, është vërtet problematik numri dhe shkak për zvarritjen e një sërë procedimesh penale është shtimi i ngarkesës së punës në prokurorinë shqiptare, që ka ardhur në rritje nga viti në vit. Siç e përmenda edhe më lart, vetëm 9-mujorin e parë të këtij viti konstatohet një rritje të numrit të procedimeve penale me rreth 36% më shumë krahasuar me një vit më parë. Ky është një volum pune, i cili përballohet nga e njëjta trupë prokurorësh. Në këto rrethana prokurorët nuk mundën t'i kryejnë të gjitha veprimet e duhura hetimore me gjithë atë ngarkesë pune që kanë.

Në lidhje me pyetjen e dytë, ky është një konstatim edhe i strukturave të tjera që ne nuk mund t'i analizojmë, por dua të theksoj se prokuroria në çdo rast që konstaton elementë të veprës penale, nis hetimet proaktive. Gjithsesi, që të mos futem në rrugën e këtyre hetimeve, të cilat më pas sjellin zvarritje të panevojshme, shteti ka struktura të specializuara, siç janë: strukturat e policisë, të Drejtorisë së Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, të tatimeve, të doganave, ILDKP-ja etj., të cilat i parapërgatitin materialet që të vijnë të plota në prokurori.

Në lidhje me pyetjen për ndryshimet ligjore, ne kemi marrë pjesë në të gjitha tryezat e diskutuara. Gjykoj se për këtë pyetje duhet të vijmë më të përgatitur para këtij komisioni për të paraqitur ndryshimet ligjore.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Majko, keni fjalën.

Pandeli Majko – Zoti prokuror i Përgjithshëm, po ju citoj dy paragrafë të raportit të BE-së.

Paragrafi i parë: “Funksionimi i sistemit të drejtësisë vazhdon të cenohet nga politizimi, llogaridhënia e kufizuar, bashkëpunimi i dobët ndërinstytucional, burimet e pamjaftueshme, zvarritjet e procedimeve dhe çështjet e prapambetura”.

Paragrafi i dytë: “Procedurat për emërimin dhe shkarkimin e personelit kyç në këtë institucion duhet të jenë transparente dhe të paanshme. Roli i këshillit të prokurorëve duhet të forcohet”.

I nderuar prokuror i Përgjithshëm, nëse sot e keni konsideruar këtë takim që ju të bëni sikur flisni dhe ne sikur ju pyesim, atëherë jemi dakord. Kam përshtypjen se sot keni ardhur për të dhënë llogari në institucionin kryesor të Republikës së Shqipërisë. Frazologjitë e përgjithshme nuk bëjnë asgjë në këtë histori. Edhe kolegët që pyetën, edhe raportimi juaj nuk kishte të bënte fare me trajtimin e këtyre dy paragrafëve. Shqetësimi ynë kryesor është fakti se marrëdhënia me korrupsionin në shtetin tonë është e diskretituar dhe ju jeni institucioni përgjegjës. Ju lutem, na flisni në mënyrë të qartë se cilat janë problemet që keni edhe me institucionet e tjera, edhe brenda jush. Dyshimi ynë më i madh është: ju jeni e njëjta trupë që keni funksionuar edhe më parë dhe vazhdoni ta trajtoni problemin sikur nuk ka ndodhur asgjë. Do t’ju zgjidhka problemin shtesa në buxhet e disa personave në personel, apo në IT? Ky qenka problemi i luftës kundër korrupsionit, apo deklarata juaj se do të ndodhin gjëra të jashtëzakonshme nga ato që do të marrim vesh për hetimet, apo nga ato që thonë në medie se po hetoni disa ish-ministra dhe ministra!? Nuk janë sekrete hetimore këto, apo po bëni politikë?!

Ju lutem, flisni qartë dhe hapur para publikut! Cilat janë problemet tuaja? Çfarë ndihme doni nga ne? Si do t’i përgjigjeni BE-së për këto që shkruan? Nuk duhet të flisni me fjalë të përgjithshme, sikur nuk ka ndodhur asgjë.

Dritëro Agolli thoshte dikur: “Na hahet, të hamë, na rriten thonjtë, t’i presim”.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Majko!

Zoti prokuror i Përgjithshëm, cili është reflektimi juaj për pyetjet dhe ndërhyrjen e kolegut Majko.

Adriatik Llalla – Faleminderit, zoti Majko, për shqetësimin me të cilin i përcillni pyetjet!

Në lidhje me ndryshimet që i duhen bërë këshillit të prokurorisë, ato i përmenda në fjalën time, por mund t’jua përsëris edhe një herë nëse nuk i patët të qarta. Nga ana tjetër, dua të theksoj faktin që pas marrjes së detyrës së prokurorit të Përgjithshëm nuk është bërë asnjë emërim, transferim, ulje ose ngritje në detyrë në kundërshtim me ligjin, proceset kanë qenë transparente. Kanë qenë vetëm disa raste ku janë bërë emërimet dhe ato janë bërë në bazë të vendimeve të gjykatave.

Në lidhje me luftën kundër korrupsionit, është fakt dhe e ripërsëris se një ndër pengesat kryesore të punës së prokurorisë shqiptare është mungesa në stafin e saj. Nuk mundet që me këtë ngarkesë të madhe pune ky numër prokurorësh të përballojë këtë sfidë të madhe të shoqërisë shqiptare. Ne kemi bashkërendim shumë të mirë të punës me institucionet e tjera ligjzbatuese me Policinë e Shtetit, me tatimet dhe me doganat, por gjithsesi në krye të këtyre hetimeve mbetet gjithmonë prokuroria dhe ne punojmë vazhdimisht për t'i drejtuar këto hetime.

Nëse jeni shqetësuar nga deklaratat e mia publike, mbetet shqetësim juaji. Unë do ta përmend sërish, ne jemi në proces dhe do të vijojmë të hetojmë çdo rast për të cilin kemi dyshime. Rezultatet do t'i nxjerrin hetimet konkrete.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Zoti prokuror i Përgjithshëm, unë do të bëj një koment, për të cilin kërkoj edhe mirëkuptimin e kolegëve, sepse si rregull nuk lejohet.

Unë mendoj se edhe ju duhet ta mirëkuptonit kolegun Majko, sepse ndërhyrja e tij ishte në sensin që ka nevojë për një veprim shumë më proaktiv të institucionit të prokurorisë në raport me pritshmërinë që kanë qytetarët shqiptarë, por edhe partnerët tanë ndërkombëtarë në këtë fushë. Pa dyshim, kjo nuk do të thotë se janë jashtë vëmendjes problematikat, shqetësimet dhe nevojat që ka për mbështetje Prokuroria e Përgjithshme. Jo rastësisht dy pyetjet e tjera të kolegëve, të zotit Manja dhe të zonjës Hysi, ishin pikërisht për mbështetjen që ka institucioni i prokurorisë. Pra, ne i shikojmë të dyja anët e gjësë: edhe nevojën që ka vetë prokuroria për të qenë shumë më aktive në ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësiive të saj kushtetuese e ligjore, por edhe përgjegjësitë që ne kemi për ta mbështetur institucionin e prokurorisë. Gjithsesi, le të mbetemi te pyetjet.

Pyetja ime e parë lidhet me progresraportin e vitit 2013, i cili thotë: “Mungesa e llogaridhënies së Prokurorisë së Përgjithshme është shqetësuese”.

Kalojmë te raporti i vitit 2014: “Mungesa e llogaridhënies së Prokurorisë së Përgjithshme mbetet shqetësuese”.

Brukseli nga njëri raport në tjetrin ka të njëjtin konstatim, ka të njëjtën gjetje, si dhe ka të njëjtin shqetësim. Ajo që dua të dëgjoj unë, kolegët, por edhe partnerët është: a ka diçka që nuk shkon në raportin e hartuar nga Brukseli, për shembull, nuk e njeh realitetin dhe atë çka ndodh në Prokurorinë e Përgjithshme, apo ka diçka që duhet të na bëjë të reflektojmë, ju

dhe neve, po flas edhe ne këtu si komision, sepse edhe unë mendoj se realisht ka diçka për të cilën ne duhet të jemi më të vëmendshëm? E bëj këtë pyetje, sepse edhe në raportin që do të vijë nuk duhet të vazhdojë të thuhet e njëjta gjë, ku të shtohet vetëm fjala: “përsëri mbetet shqetësuese”. Kjo nuk është në të mirë as të institucionit tuaj, as të Kuvendit, as të përgjegjësisë së përbashkët që kemi.

Konstatimi i dytë i raportit lidhet me akuzat për korrupsion brenda sistemit të drejtësisë, që mbetet një shqetësim serioz. Nuk dua t’u hyj disa gjërave për të cilat personalisht kam gjykim të ndryshëm për sa u përket çështjeve që janë duke u gjykuar ose hetuar për gjyqtarë, të cilët për një vjedhje prej 500 mijë lekësh i çojnë në burg dhe disa të tjerë që marrin miliona euro vazhdojë të rrinë të qetë rrugëve të Tiranës. Unë do t’i qëndroj një gjëje, që është shumë e rëndësishme: jua kam thënë edhe një herë, e kam vlerësuar konstatimin tuaj që lufta kundër korrupsionit fillon nga prokuroria. Pyetja ime është: a ka ndonjë të korruptuar brenda sistemit të prokurorisë: oficer të Policisë Gjyqësore ose prokurorë, të cilët duhet të ndëshkoheshin, pavarësisht nga mënyra e ndëshkimit? Kjo do të jetë një përgjegjësi administrative apo penale? A ka të tillë?

Ju përmendët këtu nevojën për mbështetje, sepse ka 36 apo më shumë regjistrime të çështjeve penale. Kjo mua nuk më thotë ndonjë gjë, që të jem i sinqertë, mund të ketë regjistrime, por mund të ketë edhe kaq mosfillime. Për shembull, Njësitë e Task Forcave ju nuk i keni me mungesa, me sa di unë. Kur flasim për korrupsionin përgjegjësia kryesore lidhet me to. Pyetja ime e drejtpërdrejtë është: a keni ju një analizë pse ka zvarritje të procedimeve dhe sa lidhet kjo realisht me këto mungesa? Në çfarë shkalle ka nevojë ta mbështesim ne prokurorinë, duke gjykuar nga nevoja për të pasur një lidhje me të mirë midis rezultatit që kërkojmë dhe mungesës së burimeve njerëzore?

Adriatik Llalla – Për sa i përket pyetjes së parë, dua të theksoj se nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Ministrave kemi paraqitur kërkesën tonë për amendimet e ligjit për prokurorinë, përfshirë këtu edhe kërkesën për ndryshimin e mënyrës së funksionimit të këshillit të prokurorisë, kërkesë të cilën e kemi diskutuar edhe bashkërisht jashtë këtij komision.

Fatmir Xhafaj – Nuk kishte lidhje fare me pjesën e këshillit të prokurorisë, sepse unë e kam të qartë që ajo do të jetë pjesë e reformës në drejtësi, e cila do të fillojë shumë shpejt. Jam shumë i qartë për këtë gjë.

Adriatik Llalla – Në lidhje me konstatimet e progresraportit për këshillin e prokurorisë, unë gjykoj se edhe këto do të jenë pjesë e ndryshimeve të tjera në ligj.

Pavarësisht se ne momentalisht e kemi rregulluar atë me një urdhër të prokurorit të Përgjithshëm, të diskutuar në këshillin e prokurorisë, mendoj se kjo do jetë pjesë e rregullimeve të tjera ligjore.

Në lidhje me pyetjen për hetimet e rasteve të ndryshme të veprave penale, kryesisht të korrupsionit, dua të theksoj se një ndër rastet e hetuara brenda sistemit të drejtësisë është rasti i një prokurori, i cili është hetuar, ka marrë masën e sigurimit arrest me burg, më pas u la nga gjykata një masë më e butë siguri dhe momentalisht është në proces gjykimi, ashtu siç janë edhe punonjës të tjerë, oficerë të një prokurorisë së rrethit të Kukësit.

Forcimi i strukturave të Njesisë së Task Forcës është bërë duke tërhequr personel nga ana e strukturave të tjera të prokurorisë shqiptare, duke krijuar në këtë mënyrë mungesë personeli të strukturat e tjera. Pavarësisht se këto struktura kanë një numër të pranueshëm personeli, hetimet e kësaj natyre kanë problematika e vështirësitë e veta dhe rezultatet, normalisht, nuk mund të priten për një periudhë tepër të shkurtër. Në mjaft raste këto janë procese hetimore që zgjasin për shkak të letërporosive dhe të veprimeve hetimore që kryhen në shumë raste edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Petrit Vasili - Për të qenë më konkret, konstatimet e progresraportit janë të rëndësishme. Megjithatë, edhe nga informacioni që prokurori i Përgjithshëm dha këtu, u evidentua që ka disa mungesa objektive, të cilat e kushtëzojnë punën e prokurorisë. Njëkohësisht realiteti provon që, edhe nga problemet e energjisë elektrike, por edhe për çështje të tjera, volumi i punës është rritur në mënyrë të dukshme dhe pse jo impresionante. Unë dua t'ju bëj një pyetje të drejtpërdrejtë: jemi në momentin e diskutimit të projektbuxhetit, a ka reflektime, qoftë në burimet njerëzore, qoftë në pjesën e investimeve, të cilat janë të domosdoshme për punën e prokurorisë, për t'j dhënë përgjigje këtyre mungesa, që janë objektive, u demonstrojnë si të tilla, dhe më tutje të ecim me të tjerat, në mënyrë që një diskutim apo raportim të mëtijshëm të jemi të çliruar nga kjo problematikë? Pra, të themi që u dhamë përgjigje këtyre pyetjeve dhe na mbetet të shikojmë ritmin e punës së prokurorisë. Momenti më i mirë besoj se është ky. Nuk dua një analizë, sepse projektbuxheti do të diskutohet më vete, por meqenëse këto konstatime të progresraportit kushtëzohen nga këto mungesa objektive, që prokuroria i ngre në mënyrë të vazhdueshme, ka ardhur momenti për të pasur një përgjigje të thjeshtë: a ka reflektime në këtë akt që vjen tani për këtë çështje?

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Vasili!

Zoti Llalla, fjala është për ju.

Adriatik Llalla – Në lidhje me pyetjen e zotit Vasili, dua të theksoj se nga të dhënat që ne kemi marrë paraprakisht nga Ministria e Financave, nuk ka asnjë ndryshim në raport me vitin e kaluar. Stafi i Prokurorisë së Përgjithshme shton vetëm 13 punonjës të administratës dhe nuk ka asnjë ndryshim tjetër në buxhetin e institucionit tonë, pavarësisht rritjes së dukshme të numrit procedimeve penale që ka nën hetim institucioni i prokurorisë.

Fatmir Xhafaj – A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Zoti Qefalia keni fjalën.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti prokuror, në progresraport thuhet që Shqipëria duhet të zhvillojë dhe të miratojë vlerësimet strategjike në krimin e organizuar, kryesisht bashkëpunimi i ngushtë me EUROPOL-in, madje thuhet se duhen përmirësuar hetimet proaktive bazuar në informacionet sekrete. Unë dua të di: teknikat speciale të hetimit financiar nuk janë zbatuar në mënyrë sistematike për mungesë të fondeve dhe të pajisjeve të përgjimit, apo për çfarë?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Qefalia!

Zoti prokuror, përgjigjja juaj.

Adriatik Llalla – Këto hetime kanë specifikën e tyre, që në shumicën e rasteve veprimet paraprake kryhen në strukturat e Policisë së Shtetit, para se rastet t'i referohen prokurorisë për të kryer veprime të mëtejshme. Megjithatë, problematika që kemi ngritur, edhe në kërkesat tona që i kemi paraqitur Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Financave, ka qenë edhe fakti i mungesës së pajisjeve të teknologjisë speciale të hetimit, siç janë edhe pajisjet e përgjimit.

Fatmir Xhafaj – Pyetje të tjera?

Zoti Braho, fjala është për ju.

Spartak Braho – Unë nuk do t'i hyj asaj problematike që lidhet me rekomandimet e progresraportit, sepse personalisht e kam një ide. Por do ta quaj të pajustificuar faktin që Prokuroria e Përgjithshme në buxhetin e këtij viti nuk ka asnjë shtesë.

Fatmir Xhafaj – Zoti Braho, nesër do të flasim për buxhetin.

Spartak Braho – Unë po dëgjoj prokurorin, nesër flasim përsëri.

Prokurori thotë që nuk ka asnjë shtesë, kjo është për të vënë duart në kokë. Zoti prokuror i Përgjithshëm, çfarë shtesash kërkon ju në lidhje me trupën e oficerëve të Policisë Gjyqësore apo të prokurorëve? Konkretisht, na thoni sa kërkon?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, edhe për pyetjen indirekte për Brukselin!

Zoti prokuror i Përgjithshëm, keni fjalën.

Adriatik Llalla – Faleminderit, zoti Braho!

Për vitin 2015 prokuroria shqiptare ka kërkuar nga qeveria dhe Kuvendi i Shqipërisë një shtesë organike prej 97 punonjësish, ndër të cilët: 35 prokurorë, 18 oficerë të Policisë Gjyqësore, 3 ekspertë dhe 24 punonjës të Teknologji së Informacionit, kjo në kuadër të zbatimit të projektit të menaxhimit të rasteve, si dhe 12 sekretarë, 3 arkivistë dhe punonjës ndihmës të tjerë të administratës.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit për përgjigjen koncize!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Zoti prokuror i Përgjithshëm, faleminderit!

Unë shpresoj që ju, kolegët dhe media të jeni të gjithë të mirëkuptuar për rëndësinë që kanë gjetjet dhe rekomandimet e progresraportit të vitit 2014 të Komisionit Europian për sistemin e drejtësisë në tërësi dhe organin e prokurorisë në veçanti. Ato janë thelbësore për procesin e integritetit të vendit, për detyrimet që duhet të plotësojë vendi në rrugën drejt anëtarësimit të plotë në BE.

Unë mendoj se në këtë sens duhet parë edhe përgjegjësia e këtij komisioni, sepse besoj se është i njohur fakti që Prokuroria e Përgjithshme përgjigjet vetëm para Kushtetutës dhe ligjit, por jep llogari para qytetarëve dhe të vetmit institucion në Republikën e Shqipërisë, para Kuvendit dhe këtij komisioni, që është përgjegjës. Kjo do të thotë që nga pikëpamja institucionale Prokuroria e Përgjithshme, zyra e prokurorit të Përgjithshëm, marrëdhënien institucionale në llogaridhënie dhe në raportim, sipas Kushtetutës dhe ligjit, e ka me këtë komision dhe me Kuvendin e Shqipërisë. Natyrisht, përmes këtij komisioni është qenë përgjegjëse vetëm para Kushtetutës dhe ligjit.

Por ka disa gjëra që mendoj se janë përgjegjësi e këtij komisioni, të cilat shumë shpejt do të reflektohen në ndërhyrjet përkatëse ligjore, si në reformën në drejtësi, por edhe me mbështetjen e nevojshme që duhet të jetë, qoftë edhe nëpërmjet buxhetit, siç u tha këtu, duke justifikuar merakun e madh të disa kolegëve.

Unë i kërkoj zyrës së prokurorit të Përgjithshëm, që është e lehtë për të bërë disa kërkesa. Në fillim duhet të pranohet fakti se Prokuroria e Përgjithshme në buxhetin e vitit të kaluar ka 24% rritje në raport me buxhetin e një viti më parë, atë të 2013-s. Fakt ky i konstatuar lehtësisht edhe në këtë progresraport të Komisionit Europian. Natyrisht do të ketë ndryshime edhe kur të trajtohet kjo çështje ditët në vijim, sipas rendit dhe një logjike procedurale që ka ky komision, si dhe çdolloj komisioni që funksionon në bazë të Rregullores dhe kalendarit të punës së Kuvendit.

Unë dëshiroja që ne të kishim një analizë më të plotë pse duhen këto shtesa, sa janë realisht të domosdoshme dhe dhënia e këtyre mundësive shtesë sa do të efektojnë realisht në cilësinë e punës së prokurorisë? Është e lehtë të themi se duhen 97 punonjës këtu, 100 të tjerë atje, 50 atje, ne i mirëkuptojmë të gjitha, por është shumë e rëndësishme dhe duhet të ketë argumente të forta për t'i mbështetur këto kërkesa. Unë besoj se zyra e prokurorit të Përgjithshëm, sepse nuk merret prokurori me këto çështje, por ka zyrtarë të tjerë, duhet ta bëjë këtë mbrojtje, që ta bindin këtë komision dhe Kuvendin për të bërë ndryshimet e nevojshme.

Nga ana tjetër, besoj se është në vëmendjen tuaj dhe të prokurorit fakti që ne kemi miratuar një rezolutë në fillim të këtij viti. Në fund të vitit, sipas asaj rezolute, prokurori i Përgjithshëm do të jetë për të raportuar për një çështje të caktuar: luftën kundër korrupsionit. Në fillim të vitit do të vijë për të raportuar në lidhje me ecurinë e kriminalitetit në vend, si dhe për reformën në drejtësi, ku zyra e prokurorit dhe vetë prokurori do të jenë shumë aktivë. Pra, muajit që do të vijë prezenca e prokurorit, në respekt të detyrimit që ka ndaj Kushtetutës dhe ligjit, do jetë shumë më aktive. Kështu që do të kemi rast për t'i drejtuar pyetje apo për të bashkëbiseduar me prokurorin.

Faleminderit, zoti prokuror i Përgjithshëm!

Falënderoj edhe bashkëpunëtorët tuaj!

Punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 12.11.2014, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për progresraportin e vitit 2014.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Nard Ndoka, Silva Caka dhe Tahir Muhedini.

Mungojnë:

Edi Paloka, Kastriot Islami, Armando Prenga, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Mark Frroku, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Tom Doshi, Pirro Lutaj dhe Eduard Halimi.

Të ftuar:

Igli Totozani – Avokati i Popullit

Etilda Gjonaj – komisionere te Avokati i Popullit

Arben Shkëmbi – komisioner te Avokati i Popullit

Ermir Kapedani – komisioner te Avokati i Popullit

Fatmir Xhafaj – Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, e cila nuk është për buxhetin, për të gjithë ata që nuk kanë pasur mundësi ta lexojnë rendin e ditës, por është një seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit.

Mirë se erdhët, zoti Avokat i Popullit!

Dëshirojmë t'ju dëgjojmë si pjesë e procesit të seancave dëgjimore të ndërmarra nga ky komision i nderuar në reflektim të progresraportit të vitit 2014 të Komisionit European. Ky proces është i rëndësishëm për ne si përfaqësues të institucionit më të lartë ligjvënës dhe përfaqësues të popullit, por njëkohësisht është i rëndësishëm edhe për reflektimet tuaja ndaj progresraportit. Meqenëse ky është komisioni përgjegjës për këtë fushë, ju kemi thirrur për t'ju dëgjuar mbi qasjet, konstatimet dhe rekomandimet e progresraportit lidhur me veprimtarinë e institucionit që ju drejtoni.

Besoj se do të bëni një parashtrim të shkurtër, pastaj do të kalojmë te pyetjet e kolegëve.

Fjala është për ju.

Igli Totozani – Do të mundohem të flas sa më shkurt, zoti kryetar, por ju e dini që problematika është shumë e gjerë dhe nuk mund t'i përmendim të gjitha gjërat.

Po hyj menjëherë në temë. Kam ardhur këtu me tre komisionerët e institucionit të Avokatit të Popullit. Edhe për ne raporti i progresit është një udhërrëfyes i punës sonë të përditshme, sepse ka një pjesë të mirë të tij që kujdeset ndaj shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut.

Po mundohem të flas shpejt në mënyrë që të kemi kohë pastaj për t'u dhënë përgjigje pyetjeve që mund të bëni ju.

Për sa i përket administratës publike, ju e dini që raporti ka dhënë disa vlerësime pozitive, madje jo vetëm për administratën publike, por në tërësi për çështjet e të drejtave të njeriut, por që natyrisht ka edhe problematika të tjera. Unë nuk po ndalem te vlerësimet, por po flas në mënyrë të përgjithshme për problematikat që kemi ndeshur gjatë punës sonë.

Gjatë këtij viti, që koïncidon me periudhën e përgatitjes së raportit, pra tetor 2013-tetor 2014, janë trajtuar 233 ankesa pranë Avokatit të Popullit lidhur me administratën publike. Ne kemi konstatuar disa prej problematikave kryesore.

Në radhë të parë, është rasti se, pavarësisht daljes së një VKM-je, mbetet ende e paplotësuar me aktet nënligjore të parashikuara nga vetë ligji. Pra, ligji i ri i nëpunësit civil ka nevojë të përmirësohet me disa akte nënligjore. Kjo duhet të ndodhë sa më shpejt për mendimin tonë. Në studimin që ne u kemi bërë ligjit dhe akteve nënligjore rezulton se ka

nevojë për përmirësime, sidomos dispozitat që parashikojnë ristrukturime të institucioneve të pavarura, konkretisht neni 50 i ligjit. Nga ankesat na rezultuar se vazhdon të mbetet problematikë personat që kanë dalë në listepritjeje përpara hyrjes në fuqi të ligjit, ku shumica e tyre janë bërë pjesë e shqyrtimeve gjyqësore. Nga vendimet gjyqësore rezulton se gjykatat i kanë dhënë një fuqi prapavepruese vendimit të Gjykatës Kushtetuese për ligjin e nëpunësit civil, duke e konsideruar nxjerrjen në listat e pritjes si akt të pavlefshëm dhe kanë kërkuar kthimin në vendin e punës të të gjithë punonjësve. Për këtë arsye sugjerojmë të studiohen nga DAP-i sesi do të ekzekutohen këto vendime të gjykatave me kthim në vendin e mëparshëm të punës, një shqetësim, duke pasur parasysh që ka pasur edhe ndryshime strukturore në këto ministri.

Çështja tjetër që kemi konstatuar nga ankesat që na vijnë ne ka të bëjë kryesisht me vazhdimin e një numri të konsiderueshëm individësh në marrëdhënie pune me kontratë. Për këtë arsye sugjerojmë zbatimin e standardeve të vendosura në kuadrin ligjor ekzistues për zgjidhjen në mënyrë të njëanshme të kontratës individuale të punës në rastet kur kemi zgjidhje të tilla.

Një tjetër çështje me rëndësi është ajo e administratës publike në nivel lokal. Mendojmë që në kuadër të reformës territoriale duhet të vlerësojmë me kujdes përfshirjen e zyrtareve të pushtetit vendor në sistemin e nëpunësve civilë. Sugjerojmë, gjithashtu, në funksion të konstatimeve të nxjerra më sipër të ketë rritje të kapaciteteve të stafeve të administratës publike që janë përgjegjëse për ndjekjen e procedurave për largimin nga puna, me qëllim që të realizohet kuptimi dhe zbatimi i drejtë i procedurës së parashikuar në ligj dhe t'u garantohen punëmarrësve të drejtat e sanksionuara.

Një element tjetër i rëndësishëm është se duhet t'i krijohen të gjitha mundësitë shoqërisë civile që të monitorojë punën e administratës publike. Pra, jo vetëm Avokatit të Popullit apo Komisionerit për Shërbimin Civil, por edhe organizatave të shoqërisë civile duhet t'ju garantohen të gjitha mundësitë që ato të kryejnë këtë monitorim të jashtëm.

Një tjetër çështje që mendojmë se është gangrenë është zbatimi vendimeve gjyqësore, sidomos i atyre vendimeve që kërkojnë dëmshpërblimin për heqjet e paligjshme nga puna apo kthimin në vendin e punës. Sugjerojmë se duhet të përgatitet një plan veprimi për zbatimin e këtyre vendimeve. Natyrisht që të gjithë jemi të mendimit se vendimet gjyqësore duhet të zbatohen dhe nuk diskutohen. Mirë është, meqë janë në një masë të madhe, të ketë një plan veprimi, në mënyrë të tillë që këto vendime të zbatohen.

Brenda këtij viti Avokati i Popullit i ka dërguar parlamentit një raport të posaçëm në lidhje me situatën në administratën publike, e lidhur kjo edhe me ligjin e ri të miratuar, dhe brenda një periudhë shumë të shkurtër, ndoshta njëmuajore, do t'ju dërgojmë një raport të dytë për situatën në administratën publike. Ky raport përfshin një pjesë të mirë të vitit në vijim mbi gjetjet që kemi. Ky është një raport i përgjithshëm dhe i konsultuar me shumë organe shtetërore, me gjykatat administrative për të krijuar një situatë më të qartë lidhur me gjendjen në administratën publike.

Po i marrim me radhë çështjet sipas asaj që ka paraqitur progresraporti. Ndihma ekonomike rezulton me një numër të madh ankesash që ka marrë Avokati i Popullit. Mund t'ju them se gjatë vitit tetor 2013-tetor 2014 janë rreth 170 ankesa për ndihmën ekonomike. Vetëm gjatë dy javëshit të fundit kemi marrë në Elbasan rreth 110 ankesa për ndërprerje të ndihmës ekonomike, kryesisht nga komuniteti roman dhe ai egjiptian.

Na ka rezultuar se nga zbatimi i projektit pilot për përfitimin e ndihmës ekonomike në qytetet Tiranë, Elbasan, Durrës janë përjashtuar nga skema e përfitimit të kësaj ndihme kryefamiljarë që jetojnë vetëm, si dhe familje me pak anëtarë. Në ankesat e ardhura rezulton se këto familje jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike, pa asnjë të ardhur financiare. Anëtarë të këtyre familjeve, sipas pretendimeve të ngritura nga ankesa, janë të papunë. Po sipas përmbajtjes së ankesave rezulton se ata kanë aplikuar pranë zyrave të punësimit, por nuk iu është ofruar asnjë mundësi punësimi. Në kushtet e papunësisë, duke shtuar edhe ndërprerjen e pagesës së ndihmës ekonomike, jeta e tyre është vështirësuar shumë.

Për sa më sipër, ne sugjerojmë të bëhet një analizë e kujdesshme e projektit pilot që po zhvillohet në rrethet Tiranë, Durrës dhe Elbasan pikërisht për të kuptuar problematikat që ndodhin në këto raste se si është e mundur që familje në kushtet e një varfërie ekstreme të mund të mos përfitojnë apo t'u ndërpritet ndihma ekonomike. Ne kërkojmë të bëhet një analizë e kujdesshme e përmbajtjes së pyetësorit të formulari përkatës që aplikohet në këtë rast, të bëhet një rishikim i tij, pasi kemi konstatuar se ka pyetje të cilat janë delikate dhe që mund të ndryshojnë fatin e ndihmës ekonomike për një familje, pra mund të shkaktojnë edhe ndërprerje, megjithëse familjet mund të ndodhen në një situatë varfërie ekstreme.

Lidhur me strehimin, edhe ai mbetet një problem shumë i madh në Shqipëri. Avokati i Popullit në filozofinë e punës së tij strehimin e lidh shumë me shëndetin e shoqërisë. Për Avokatin e Popullit strehimi mbetet një nga elementet bazë të një familjeje të shëndoshë, por duhet të thënë se është një nga plagët më të mëdha që ka sot shoqëria shqiptare. Mund t'ju them sot, në mënyrë të përafërt, ndoshta me një gabim të vogël, se janë rreth 17 mijë familje

të pastreha në Shqipëri, ndërkohë që vetëm 2 mijë të tilla kanë mundur të trajtohen me strehim social.

Problematika nuk qëndron vetëm këtu, por edhe në faktin se edhe ato mundësi të paktën të kredive me interes zero janë pothuajse të pamundura për familjet e varfra. Duke iu referuar numrit të konsiderueshëm të ankesave, mund të them se nga viti 2011 ne kemi 600 ankesa për mungesën e strehimit dhe në periudhën tetor 2013-tetor 2014 janë trajtuar 119 ankesa. Problematika që konsiston është se sidomos ajo që lidhet me bashkitë e vogla, të cilat nuk kanë buxhet të mjaftueshëm që të ofrojnë si alternativë për strehimin banesa me qira ose të shpërndajnë banesa sociale. Një pjesë e mirë e bashkive nuk janë të përgatitura për sigurimin e vendstrehimeve ose të vendqëndrimeve në raste emergjente. Familjet qiramarrëse, pas thyerjes së aktit normativ nr. 3, datë 01.08.2012, janë gjetur të pambështetura nga shteti. Mund t'ju them se ai akt vazhdon edhe sot e kësaj dite të prodhojë efekte shumë të rënda sociale dhe ka qenë i pashoqëruar nga një analizë dhe nga një studim i hollësishëm i gjendjes reale dhe i pasojave që mund të sillte. Të gjitha mënyrat ose zgjidhjet që parashikonte ky akt janë pothuajse të perealizueshme për qytetarët, të cilët kanë humbur familjet e tyre dhe sot janë në kushte vërtet të vështira. Sot po gjendemi përpara faktit, i cili na trishton si institucion, që familjet më të varfra jo vetëm që nuk po përfitojnë nga programet e strehimit për shkak të pamundësisë së tyre financiare për të përballuar shpenzimin qoftë edhe pjesërisht ose me kosto të ulët. Gjithashtu, edhe ata që kanë përfituar një herë, por që nuk i përballojnë dot kështet e kredisë, po nxirren nga shtëpitë, në një kohë që streha është e vetmja gjë që nuk duhet të preket dhe të hidhet në rrugë një familje me shumë fëmijë ose persona me aftësi të kufizuara etj. Në këtë drejtim, kemi një sërë rekomandimesh të Avokatit të Popullit, të cilat synojnë rishikimin e politikave të shpërndarjes së fondeve për njësitë e qeverisjes vendore, por nga institucionet përgjegjëse duhet të sigurohet trajtimin me prioritet i rasteve të veçanta, sidomos i personave me aftësi të kufizuara, i grupeve vulnerabël, i romëve dhe i egjiptianëve, të cilët jetojnë në kushte shumë të rënda ekonomike. Ne kërkojmë të bëhet një studim urgjent për pasojat e aktit normativ në mënyrë që t'u gjendemi atyre qytetarëve, të cilët i kanë vuajtur dhe vazhdojnë t'i vuajnë këto pasoja edhe sot e kësaj dite.

Po kaloj shkurtimisht në një problem tjetër të rëndësishëm, i cili ka të bëjë me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Situata e procesit të ekzekutimeve të titujve të pronësisë në vlerësimin tonë nuk është në nivelin që do të dëshironim. Numri i rasteve të prezantuara për shqyrtim gjatë vitit në fjalë, tetor 2013-tetor 2014, arrin në 68 vendime të pazbatuara.

Vlen të theksohet se për ato raste, kur organe të caktuara të administratës publike janë ngarkuar me detyrimin sipas vendimit gjyqësor, është e pajustificueshme zvarritja e zbatimit të këtyre vendimeve dhe e vendimeve të Gjykatës së Strasburgut. Avokati i Popullit brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore do të t'ju dërgojë raportin e posaçëm nr. 2 lidhur me zbatueshmërinë e vendimeve gjyqësore në Shqipëri.

Një tjetër çështje e rëndësishme ka të bëjë me politikën antikorruption. Avokati i Popullit është një institucion që ka qenë mjaft aktiv në bashkëpunim me strukturat shtetërore në këtë drejtim, në përgatitjen e Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit, si edhe planit të veprimit përkatës. Gjithashtu, Avokati i Popullit është organi që ka përgatitur rekomandimin për ligjin e bilbilfryrësve, i cili, me sa di unë, ka kaluar dhe është një arritje jo e vogël në luftën kundër korrupsionit.

Për sa u përket burgjeve, janë rreth 170 ankesa të ardhura nga to. Gjendja është e vështirë. Ka një mbipopullim ekstrem të tyre, në një përqindje shumë të madhe mbipopullimi. Kjo ka krijuar kushte shumë të vështira qoftë në paraburgim, qoftë në burgje. Po kështu, për faktin se një numër ndërtesash të reja për burgje ose për paraburgim të parashikuara për t'u hapur nuk janë hapur ende, gjendja vazhdon të jetë jo e mirë. Burgjet vuajnë në të dyja drejtimet, qoftë për sa i përket infrastrukturës, e cila është e vjetër, me lagështirë, por edhe nga paaftësia që t'u sigurojë kushte minimale sportive dhe higjienike të burgosurve apo të paraburgosurve. Gjithashtu, flitet për një situatë po kaq të vështirë nga pikëpamja e shërbimeve sociale apo atyre shëndetësore, gjë që krijon një pamundësi pothuajse absolute që dënimi të ketë vlerën për të cilin jepet sot në botën bashkëkohore, pra riintegrimin e personit në shoqëri.

Një tjetër gangrenë që nuk po gjen zgjidhje është trajtimi i personave që kanë marrë masë shëndetësore nga gjykata, mjekim të detyrueshëm, të cilët, për fat të keq, gjenden sot në regjim. Kjo përfaqëson një shkelje flagrante të të drejtave të njeriut për një numër të madh personash, të cilët e kalojnë shifrën e 100 personave. Është evidente nevoja për ndërtimin e institucionit të posaçëm shëndetësor; të adresohet në mënyrë sa më shpejt, ndoshta edhe me buxhetin e këtij viti, në qoftë se është e mundur.

Një tjetër problem që përshkruhet në raport është edhe rasti i gjakmarrjes, një fenomen, të cilin, pavarësisht se raporti e konsideron si një fenomen në ulje, është ekzistues dhe ju e dini që një pjesë e mirë e qytetarëve shqiptarë qëndrojnë të ngujuar në kullat apo në shtëpitë e tyre dhe jetojnë në kushte shumë të vështira, duke iu shkelur një sërë të drejtash, duke filluar nga e drejta e jetës, e drejta për të pasur arsim, për të votuar, për t'u zgjedhur etj.

Avokati i Popullit ka përgatitur një raport të posaçëm, i cili do të diskutohet në nëntor, por ndërkohë jemi në mbyllje të një raporti të dytë të posaçëm pikërisht për gjendjen e gjakmarrjes.

Midis të tjerave ajo që duhet të themi, meqenëse progresraporti i kushtoi një kujdes të veçantë, rekomandimet tona synojnë që institucionet shtetërore të kenë një rol më aktiv në këtë drejtim. Është e pafalshme që ende, që nga viti 2005, nuk kemi zbatim të ligjit për ngritjen e këshillit koordinues për luftën kundër gjakmarrjes. Pra, ka rreth 9 vjet që ai ligj është në fuqi, por, për fat të keq, nuk është zbatuar asnjëherë.

Për sa u përket të drejtave të fëmijëve dhe të grave, pavarësisht disa arritjeve pozitive, të cilat përmenden në raport, si rritjen e numrit të mekanizmave për referimin e dhunës etj, rekomandohet nga Avokati i Popullit ngritja dhe forcimi i mekanizmave për barazi gjinore në nivel qendror dhe vendor, veçanërisht përshtetimi i procesit për emërimin e nëpunësve gjinorë në strukturat e ministrive dhe të nëpunësve vendorë për çështjet gjinore në bashkitë e vendit.

Për sa i përket komunitetit LGBT, edhe në këtë rast ka pasur arritje pozitive, të cilat janë paraqitur në raportin e progresit të Bashkimit Europian. Natyrisht, nevojiten disa masa dhe ndryshime në Kodin e Familjes, që kanë të bëjnë me unionet civile. Nevojitet, gjithashtu, përmirësim i Kodit të Punës që ka të bëjë me parashikimin e identitetit gjinor apo orientimit seksual si shkak diskriminimi, por që natyrisht besoj se janë në rrugën e duhur. Pra, në të dyja rastet bëhet fjalë për projekte që po kalojnë në institucione shtetërore, sipas informacionit që ne kemi.

Lidhur me të drejtën e pronës dhe reformën në këtë fushë, problematika vazhdon të jetë e madhe. Për periudhën tetor 2013-tetor 2014 kemi trajtuar 191 ankesa. Në lidhje me këtë kemi konstatuar tejzgjatje të procedurave administrative për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës, mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore që lidhen me pronat, vështirësi në sigurimin e dokumentacionit të plotë për të përfituar të drejtat e garantuara me ligj, mbivendosje të krijuara nga vendimmarrjet e organeve të ndryshme për të njëjtën çështje, moskompensim financiar i pronarëve të shpronësuar apo i trashëgimtarëve të tyre. Lidhur me kompensimin financiar që nga viti 2005, kur u kompensuan financiarisht subjektet e para deri në vitin 2013, kanë përfituar afërsisht 700 të tillë, në një kohë kur vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut e kanë penalizuar Shqipërinë me shifra marramendëse për moskompensimin financiar të subjekteve të shpronësuar ndër vite, të cilat

së bashku me barrën financiare të sipërcituar përbëjnë një problem mjaft serioz për shtetin shqiptar dhe angazhimin për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së pronave.

Problematikë kemi konstatuar edhe në disa aspekte të tjera. Kështu, rezulton së mungojnë të dhënat të tilla si: numri i vendimeve të AKKP-së dhe të akteve të marrjes në pronësi të tokës në pronësi të regjistruara në sistem, numri i akteve që janë në gjykim administrativ, komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë ose në gjykatë, toka që duhej për kompensim fizik etj. Për këtë arsye kemi sugjeruar së fundi së përparësi duhet të marrë evidencimi sa më i shpejtë i pronave...

(Ndërhyrje e deputetit Qefalia pa mikrofon.)

Një tjetër problem i madh që kemi konstatuar në këtë periudhë është ai që ka të bëjë me ndërtimet pa leje. Natyrisht që kemi konstatuar disa problematika nga qytetarë të caktuar. Gjatë periudhës tetor 2013- tetor 2014 kemi marrë rreth 115 ankesa nga persona të cilëve u janë prishur shtëpitë. Problematikat kryesore janë, sidomos sot kur është emergjente një ndërhyrje për të parandaluar prishjen e shtëpive, sidomos në zonën e Selitës, ku banojnë një numër i madh banorësh romë, e para, duhet të realizohen deri në fund procedurat ligjore të parashikuara, e dyta, sipas akteve ndërkombëtare të Gjykatës së Strasburgut është e nevojshme që, përpara se realizohen këto prishje, duhet të gjenden kushte të përshtatshme për trajtimin e këtyre personave.

Një tjetër problem që ne diskutojmë është çështja e minoriteve. Për sa u përket minoriteteve, ashtu sikurse është edhe në raport, Avokati i Popullit prej një viti kërkon një ligj gjithëpërfshirës për minoritetet, ku të përcaktohen qartë të gjitha definicionet e minoriteteve, që, në njëfarë mënyrë, të krijohet një ide më e qartë për numrin e minoriteteve në Shqipëri.

Për sa u përket romëve, ata vazhdojnë të jetojnë në një gjendje të vështirë dhe në një pjesë të madhe të jenë të përjashtuar nga sistemi social shqiptar. Avokati i Popullit prej dy-tri vjetësh ka realizuar disa rekomandime legjislative, të cilat nuk janë pranuar nga institucionet shtetërore, qoftë për regjistrimin dhe transferimin e të dhënave të gjendjes civile nga një qendër administrative në një tjetër, qoftë për çështjen e ndihmës ekonomike, qoftë për çështjen e strehimit. Në të gjitha rastet Avokati i Popullit është i mendimit se për shkak të kushteve të vështira të jetesës dhe të specifikave të jetesës së tyre qytetarët romë mund të konsiderohen si një grup në risk dhe, duke u konsideruar si të tillë, të mund të përfitojnë një lloj diskriminimi pozitiv në lidhje me problematikat që u ngritën pak më lart.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit për ekspozenë që gjykuat të parashtronit lidhur me gjetjet dhe me rekomandimet e progresraportit! Shpresoj ta keni mirëkuptuar edhe ndërhyrjen e kolegut Qefalia, sepse kemi qenë të kujdesshëm gjatë gjithë këtyre seancave dëgjimore, ashtu sikurse edhe në seancën e mëparshme dëgjimore kur ishte Prokurori i Përgjithshëm, që këto seanca të fokusohen vetëm te progresraporti dhe reflektimet e institucioneve sesa për ta parë në tërësi punën e institucioneve që raportojnë në Kuvend, në mënyrë që të mos dublojmë apo të mos bëjmë seanca dëgjimore, sepse pas pak muajsh do t'i ridëgjojmë përsëri institucionet në raportimin e tyre vjetor. Ky ishte edhe qëllimi i ndërhyrjes së kolegut Qefalia.

Gjithsesi, a keni pyetje?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Avokat i Popullit!

Në fakt, qëllimi i kësaj seancë dëgjimore është të pasqyrojë ose të verifikojë se çfarë është bërë me tri propozimet që bën progresraporti i Bashkimit i Europian.

Konkretisht, rritja e rolit të Avokatit të Popullit për të ndjekur zbatimin e 55 rekomandimeve të tij është rekomandimi i parë që ka bërë progresraporti.

Rritja e rolit proaktiv të Avokatit në diskutimet e projektligjeve të ndryshme dhe këshillimi më i mirë nga ana e Kuvendit dhe e qeverisë lidhur me nismat ligjore që kanë të bëjnë me Avokatin e Popullit ose me ligje të tjera.

Gjithashtu, në progresraport konstatohet se fondet buxhetore janë reduktuar për vitin 2014. Në fakt, unë do të doja të dëgjoja opinionin tuaj se çfarë është bërë lidhur me këto konstatime dhe këto rekomandime që ka bërë progresraporti i Bashkimit Europian. Në fakt, më vjen keq ta them, dëgjova një analizë të punës që ju po bëni dhe normalisht duhet ta raportoni në fillim të vitit 2015. Në fakt, sipas Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura të Kuvendit, konstatimi i BE-së lidhur me buxhetin për Avokatin e Popullit rezulton të jetë jo i saktë, sepse nga studimi i buxhetit, rezulton se ka një miratim prej 2 milionë lekësh të rinj shtesë dhe ne, me sa mbaj mend unë këtu në komision, ju rritëm edhe dy veta staf në buxhetin e vitit 2014. Unë nuk e di se ku e ka gjetur këtë informacion BE-ja, por do të doja nëse konstatimi i bërë në progresraport është i vërtetë apo i gabuar.

E dyta, pyetja ime ka të bëjë me faktin se çfarë keni bërë ju si institucion për të ndjekur zbatimin e 55 rekomandimeve? Kujt ia keni adresuar ato dhe çfarë është bërë me zbatimin e këtyre rekomandimeve?

Pyetja e fundit lidhet me konsultimin e duhur nga ekzekutivi me Avokatin e Popullit gjatë hartimit të reformave. A jeni konsultuar ju në hartimin e projektligjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe si e gjykoni ju pjesëmarrjen tuaj në këtë proces?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Zoti Totozani, ju lutem, jepni përgjigjen tuaj!

Igli Totozani – Në ftesë na u tha se ne duhej të përgjigjeshim në lidhje me problematikat e të drejtave të njeriut dhe jo për pika konkrete për të cilat foli deputetja Hysi. Megjithatë, jemi gati që t’u japim përgjigje për të gjitha këto pyetje.

Natyrisht që në progresraport janë ngritur një sërë shqetësimesh për Avokatin e Popullit. Unë po e nis nga më kryesoret, që kanë të bëjnë pikërisht me konsultimin me Avokatin e Popullit. Mund t’ju them se nuk jemi të kënaqur me konsultimin që është me Avokatin e Popullit për sa u përket ligjeve të ndryshme që prekin të drejtat e njeriut. Nëse dëshironi, mund t’ju jap edhe shembuj. Po ju sjell shembullin pozitiv të Ministrisë së Drejtësisë, e cila pothuajse të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut lidhur me burgun, policinë dhe kodet e ndryshme, janë shqyrtuar nga Avokati i Popullit dhe kanë qenë një shembull i mirë bashkëpunimi. Por natyrisht ka një sërë ligjesh të tjera, për të cilat nuk është konsultuar Avokati i Popullit. Për sa i përket rritjes së rolit të Avokatit të Popullit, është bërë një punë e dyanshme, kjo falë faktorëve dhe institucioneve të tjera të cilat në njëfarë mënyre duhet të kuptojnë siç duhet rolin e tij. Avokati i Popullit vazhdon të jetë një strukturë dhe një institucion pro-aktiv. Duke patur parasysh, përveç rasteve të ankesave që vijnë nga qytetarët edhe shumë iniciativa eksofiko, pra të drejtpërdrejta, ky numër nga viti në vit ka qenë gjithmonë në rritje për faktin se mendojmë që mund t’ju gjendemi më pranë qytetarëve, por sikurse iu thashë, shumë rekomandime tona mbeten pa përgjigje. Ka një numër të madh dhe ne në Kuvend do t’ju sjellim së shpejti një listë të të gjithë rekomandimeve që ne i kemi pa përgjigje, për t’ju kërkuar ndihmë edhe juve në mënyrë që të ndikoni te institucionet e tjera shtetërore që ata t’i përgjigjen. Kjo ndodh kryesisht me rekomandimet legislative, të cilat mund të shoqërohen edhe me fatura financiare. Problemi më i madh që ne kemi dhe që duket, e kanë konstatuar edhe kolegët tanë europianë, por jo vetëm, është fakti që shqetësuese nuk mbeten vetëm përgjigjet negative ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit; kjo është e pranueshme, sepse jo gjithmonë rekomandimet e Avokatit të Popullit mund të marrin përgjigje pozitive, kjo është një çështje që mund të hidhet në diskutim; çështja që na shqetëson më shumë ne, është mungesa e përgjigjeve. Ky është problem shqetësues për ne,

por ju do të keni shumë shpejt, ndoshta brenda javës që vjen, një tabelë të plotë të rekomandimeve pa përgjigje të Avokatit të Popullit. Aty do të përfshihen datat, titujt e këtyre rekomandimeve dhe emrat e institucioneve të cilat nuk i kanë dhënë përgjigje Avokatit të Popullit, në disa raste për të disatën herë ku janë dërguar rekomandimet. Buxheti i avokatit të popullit: Është relative të thuash nëse jemi të kënaqur me arritjen prej 2 milion lekë, të cilët janë rritur në zërin e investimeve, që në fakt tek Avokati i Popullit nuk është se luajnë një rol të jashtëzakonshëm. Natyrisht, ne i kemi përdorur dhe do t'i përdorim këto investime për të rritur përputhshmërinë e strukturës dhe infrastrukturës së Avokatit të Popullit me grupet vulnerabil, si me aftësinë e kufizuar etj. Kjo, në mënyrë që ata të rrisin aksesin e institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim dhe të shërbejnë si një institucion shembull ndaj institucioneve të tjera për të ndjekur të njëjtën rrugë që është e nevojshme. Ju e dini që shumë institucione shtetërore vuajnë nga ky problem.

Por, ajo që ne kërkojmë më shumë të çështja e buxhetit, i cili me thënë të drejtën nuk ka pasur rritje, është çështja e zyrave rajonale. Këto zyra vazhdojnë të mbeten me punonjës vullnetarë të cilët vijnë nga shoqëria civile dhe që punojnë pa pagesë. Natyrisht, është një shembull i mirë i bashkëpunimit të Avokatit të Popullit dhe shoqërisë civile, në mënyrë që këto përfaqësues të jenë të shoqërisë civile, por edhe të punojnë në mënyrë vullnetare një ditë në javë për Avokatin e Popullit. Por natyrisht që do të kishte një rritje të përgjegjshmërisë së këtyre qytetarëve vullnetarë të cilët punojnë tek ne, nëse do të kishte një pagesë kundrejt tyre. Puna e Avokatit të Popullit do të ishte shumë herë më efikase nëse zyrat rajonale, të cilat janë 7 në qytete kryesore të vendit dhe në minoritet, të mbulohehin me punonjës me rrogë të caktuar. Ne çfarë kemi bërë në lidhje me rekomandimet që janë pa përgjigje? U mundova t'iu shpjegoj, por po shtoj diçka më tepër. Institucioni i Avokatit të Popullit, sipas procedurave që ai ka, është i detyruar t'i njoftojë disa herë institucionet të cilat nuk u përgjigjen rekomandimeve të tij. Por gjithashtu veç kësaj, ne synojmë të krijojmë takime dhe bisedime me funksionarë të institucioneve të cilat nuk u përgjigjen institucionit të Avokatit të Popullit. Pra, të realizojmë një lloj procesi meditacioni të cilin jemi munduar ta aplikojmë me institucione apo me ministri të ndryshme. Natyrisht, jo gjithmonë jemi të suksesshëm, ndaj vazhdon një gjendje jo e mirë në lidhje me përgjigjet ndaj institucionit të Avokatit të Popullit. Ju falënderoj që e hapët këtë temë, ndoshta kemi nevojë për ndihmën e Kuvendit për të gjitha ato institucione të cilat nuk i përgjigjen institucionit të Avokatit të Popullit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Këtu e mbyllim ciklin e seancave dëgjimore.

Faleminderit, zoti Avokat i Popullit! Faleminderit dhe bashkëpunëtorëve tuaj që janë prezentë gjithashtu, në këtë mbledhje komisioni! Stafi i komisionit do të fillojë të përgatisë materialin që do bëhet publik dhe ajo që do të sugjeroja, me ç'konstatoj dhe nga këto seanca dëgjimore të këtyre dy javëve, kryesor është fakti që do duhet të fokusohemi fort në raportin publik që do të paraqesim lidhur me sa dhe si kanë reflektuar ndaj gjetjeve dhe konstatimeve insionet e ekzekutivit dhe ato të pavarura ndaj progres-raportit. Çështja e integritetit të mëtejshëm të vendit në Bashkimin Evropian, nuk është një çështje e qeverisë por është çështje e të gjithëve dhe në rrallë të parë dhe e legjislativit dhe institucioneve të pavarura, e gjyqësorit edhe padyshim edhe e ekzekutivit. Javën e ardhshme do të kemi paraqitjen publike të këtij raporti, ku do të japim edhe vlerësimet tona për mënyrën si kanë reflektuar dhe si kanë reaguar insionet e pavarura ndaj këtij progres-raporti dhe sa shpresë kemi ne që ky reflektim, kjo qasje, të jetë efektive në plotësim të këtyre kushteve dhe detyrave që i takojnë këtyre insioneve në këtë proces.

Natyrisht, siç e kam thënë herë tjetër, për herë të parë komisioni i ligjeve do të ketë një seancë dëgjimore vetë me shoqërinë civile, grupet e interesit dhe institucioneve të pavarura. Aty do të raportojmë mbi zbatimin e detyrave, gjetjeve, reflektimin që kemi pasur gjatë vitit të kaluar dhe reflektimin që kemi për vitin në vazhdim ndaj progres-raportit. Është një eksperiencë e re, por ne kemi menduar që ta çelim këtë traditë, sepse ashtu siç ne kërkojmë që të tjerë të informojnë, të raportojnë përpara nesh si përfaqësues të popullit, ashtu dhe ne kemi detyrimin që pikë së pari të jemi raportuesit e parë para publikut, para qytetarëve për atë çfarë ne bëjmë dhe për atë çfarë ne duhet të bëjmë më mirë në interes të proceseve integruese të vendit. Edhe njëherë faleminderit zoti Totozani, faleminderit zotërinj dhe zonja komisionerë! Punë të mbarë! I lutem zonjës Zëvendës Ministre, së bashku me ekipin që e shoqëron të paraqitet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 12.11.2014; ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për faljen e kamatëvonesave dhe gjobave për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Nard Ndoka, Silva Caka dhe Tahir Muhedini.

Mungojnë:

Edi Paloka, Kastriot Islami, Armando Prenga, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Mark Frroku, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Tom Doshi, Pirro Lutaj dhe Eduard Halimi.

Të ftuar:

Bardhylka Kospiri – zëvendësministre, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Enkelejd Musabelli - këshilltar i Ministrit

Astrit Kuka - drejtor i Sigurimeve Shoqërore dhe Pagave pranë MMSR

Ali Emini - drejtor pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore

Fatmir Xhafaj - Lidhur me projektligjin për faljen e kamatë-vonesave dhe gjobave për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi, për ta paraqitur projektin është zonja Bardhylka Kospiri, zëvendësministre në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, e shoqëruar nga zoti Enkelejd Musabelli, këshilltar i Ministrit. Zoti Ali Emini, zëvendës drejtor pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Këshilltari i marrëdhënieve me parlamentin zoti Dango. Zonja Kospiri, faleminderit që keni ardhur! Besoj do të kemi nga ju një përmbledhje të shkurtër të projektit, për shkak se kolegët e kanë të njohur, e kanë lexuar së bashku me relacionin shoqërues. Relatori, zoti Manja, është i gatshëm të japë komentimin e vetë, kështu që mund të fillojmë.

Bardhylka Kospiri – I nderuar zoti Kryetar, të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë. Ky projektligj për faljen e të gjithë kamatë- vonesave për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore, ka një rëndësi të madhe për të gjithë banorët e zonave rurale, sidomos në kuadër të reformës së pensioneve që do të hyjë në fuqi nga 1 janari i vitit 2015. Sipas ligjeve aktuale, të vetëpunësuarit në bujqësi, paguajnë një shumë fikse të kontributit që do duhej të paguajnë nëse do ishin të punësuar në bujqësi dhe pjesën tjetër e subvencionon buxheti i shtetit. Gjithashtu, të vetëpunësuarit në bujqësi mund të paguajnë edhe kontributet për vitet e shkuara, me çmimet e atyre viteve por duke paguar edhe një kamat-vonesë sipas ligjit aktual gjithmonë. Kështu, për vitin 2014 një i vetëpunësuar në zonat fushore duhet të paguajë 33 432 lekë dhe një i vetëpunësuar në zonat malore duhet të paguajë 26 432 lekë. Ndërsa për të blerë le të themi, vitin 1996, këta individë do të paguajnë aq sa do të paguanin në këtë vit, pra respektivisht 1620 lekë dhe 972 lekë plus për kamatë-vonesën. Reforma e pensionit që do të hyjë në fuqi në 1 janar 2015 do sjellë ndryshime thelbësore në këtë drejtim. Së pari, masa e kontributit për të vetëpunësuarit në bujqësi do të rritet gradualisht për tu barazuar me kontributin që paguajnë të vetëpunësuarit në qytet dhe kjo brenda vitit 2018. Gjithashtu, banorët e zonave rurale do të mund të blejnë vitet e shkuara, por pas 1 janarit ata s'do mund t'i blejnë më me çmimin e atyre viteve, por vetëm me çmimin e vitit në të cilin derdhin pagesën. Në këtë mënyrë, për të blerë vitin 1996, nuk do të paguhen më 1620 lekë, por aq sa çështë vlera reale në vitin 2014, pra 33 432 lekë. Ky projektligj që po shqyrtojmë ofron dritaren e fundit për të vetëpunësuarit në bujqësi, që të mund të paguajnë kontributet e viteve të shkuara me çmimin e këtyre viteve, madje dhe pa qenë nevoja të paguajnë kamat-vonesën. Kështu, për të blerë 9 vite sigurimi, nga viti 1994

deri në 2002, banorët e zonave rurale do duhet të paguajnë në total më pak se njëqind e dyzetë mijë lek të vjetra. Ndërkohë që vetëm viti 2014 kushton më shumë se dyfishi i kësaj shume. Ndaj dhe gjej sërish rastin që iu drejtohem të gjithë të vetëpunësuarve në bujqësi, madje dhe atyre që sot gjenden në emigrim që nëse duan të paguajnë kontributet e viteve të shkuara të nxitojnë ta realizojnë këtë deri në fund të vitit, pasi nga 1 janari i vitit 2015, kontributi që do duhet të paguajnë do të jetë shumë më i lartë. Dy muajt e fundit të këtij viti janë dritarja e fundit për të siguruar vitet e shkuara me çmime të papërfillshme me vlerën që ka sot tregu e madje edhe pa kamatë-vonesë. Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit juve!

Ulsi Manja – Faleminderit Zoti Kryetar!

Shkurtimisht, në cilësinë e relatorit, shprehem që komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe e shqyrton këtë projektligj nga pikëpamja e vlerësimit kushtetues dhe në aspektin procedural. Nga pikëpamja kushtetuese, projekt-ligji i sjellë për faljen e kamat-vonesave dhe gjobave për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi, është në përputhje me nenin 83 pika 2 të kushtetutës. Ndërsa nga aspekti procedural, ky projektligj ka respektuar parashikimet e nenit 28 dhe 68 të rregullores së Kuvendit të Shqipërisë. Sinqerisht ndihem mirë si relator i këtij projekt-ligji, pasi personalisht por dhe një pjesë e kolegëve të mi deputetë, përfaqësojmë zona që kryesisht kanë zhvillim bujqësor dhe blegtoral. Jemi deputet në zona rurale dhe ky projektligj ka për qëllim kryesor faljen e kamat-vonesave dhe gjobave për kontributet e ndryshme të sigurimeve shoqërore të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe kanë si objekt final nxitjen e personave të vetëpunësuar për të paguar kontribute për mbulimin me sigurim shoqëror të gjitha periudhave të mëparshme të cilat nuk kanë paguar kontribute duke i lehtësuar ato nga pagesa e kamat vonesave.

Si risi kryesore të këtij projektligji, unë do të veçoja: lehtëson fermerët nga ngarkesa që për gjendjen e tyre ekonomike janë të vështira për tu përballuar. E dyta, zgjerohet skema e kontributeve në fshat, pasi fermerët duke qenë kontribuues do të jenë në skenë edhe nëse masa e kontributeve në fshat do të rritet. E treta, lehtësohet skema e ndihmës ekonomike sepse me pagesën e kontributeve fermerët përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore. Së katërti, rriten të ardhurat vjetore në skemat e sigurimeve shoqërore të vetëpunësuarve në bujqësi. Projektligji në fjalë parashikon se, e drejta personave të vetëpunësuar në bujqësi që përfitojnë nga ky projektligj mund të ushtrohet deri në datën 31 dhjetor 2014. Si përfundim,

të nderuar kolegë, në cilësinë e relatorit, ju ftoj ta votojmë këtë projektligj për t'ia kaluar seancës plenare për votim.

Faleminderit, zoti Manja edhe për mbështetjen që i dhatë këtij projekti!

Mund të kalojmë te pyetjet. Kush ka pyetje? Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Kospiri!

Unë e vlerësoj dhe e përshëndes këtë nismë që merr institucioni juaj për të mbështetur pjesën e të vetëpunësuarve në bujqësi, por në lidhje me relacionin unë kam dy pyetje dhe për të sqaruar si veten edhe publikun. Ju keni thënë në relacion që falja e kamat-vonesave është zbatuar dhjetë herë deri më sot. Jam shumë dakort, duhet ti hapim fund informalitetit dhe pyetja ime është kjo. A ka ndikuar realisht falja e kamatë-vonesave në rritjen e numrit të personave të regjistruar si të vetëpunësuar?

Gjithashtu, ju thoni se kjo do bëhet vetëm për të vetëpunësuarit në bujqësi. Po në lidhje me të vetëpunësuarit në sektorë të tjerë, jo në bujqësi, a mendoni që ka nevojë të bëhet ndonjë falje tjetër e kamat-vonesave para se të hyjë në fuqi skema e re e pensioneve në 1 janar? Gjithashtu, pyetja e dytë ka të bëjë me faktin se çfarë po bëni ju konkretisht për të nxitur ose për të informuar çdo të vetëpunësuar në çdo skaj të Shqipërisë. E pyes këtë, sepse këto ditë kam marr shumë kërkesa, telefonata për të sqaruar këtë projekt-ligj, ndërkohë që ne sot po e diskutojmë por ka nga këta punonjës që shesin rrugëve dhe pyesin. Dhe kuptova që e kishin shumë të paqartë mënyrën e funksionimit të skemës dhe të zbatimit të ligjit. Çfarë po bëni ju në këtë periudhë shumë të shkurtër, se është deri më datë 31 dhjetor të 2014?

Dhe pyetja e tretë, në relacion ju thoni që për muajt nëntor-dhjetor janë planifikuar të sigurohen tridhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë të vetëpunësuar në bujqësi dhe në një paragraf më poshtë thoni që do të kemi rreth njëzetë mijë të vetëpunësuar të rinj, të cilët do të vetëpunësohen. Kjo njëzetë mijë është brenda numrit tridhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë? Sepse nuk arrij të kuptoj numrin real sa do të jenë përfituesit. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Kush do të përgjigjet? Zoti Emini? Po. Me mikrofon të lutem që të regjistrohet.

Ali Emini – Atëherë, ne jemi dakord se nga viti 1999 e deri më sot ka pasur pothuajse për çdo vit ose njëherë në dy vjet falje të kamatë-vonesave të personave që zhvillojmë aktivitet bujqësor dhe blegtoral dhe në kuptim të ligjit të sigurimeve shoqërore quhen të vetëpunësuar në sektorin bujqësor. Natyrisht që të gjitha faljet janë mbështetur dhe kanë pasur parasysh të zgjidhin disa probleme që kryesisht janë të lidhura me problemet që

ka pasur pronësia. Në shumë zona ka pasur vonesa në marrjen e certifikatave ose në identifikimin e personave të vetëpunësuar në bujqësi. Shumë të tjerë kanë pasur problematika të të ardhurave po edhe moskuptim të pjesëmarrjes në skenë , kështu që në të gjitha rastet që janë bërë falje të kamatë-vonesave , sidomos në dy muajt e fundit të vitit, ka pasur një fluks shumë të madh të mbulimit me kontribut të periudhave të sigurimit që në fund të fundit bëjnë mirë sepse rriten të ardhurat e skemës së sigurimeve shoqërore, njerëzit arrijnë të marrin vite pune. Por, siç u tha dhe nga relatori, edhe për këtë arsye bëhen shmangie nga probleme sociale, por edhe nga ndihma ekonomike që mund ti pres si rrjedha e fundit. Çfarë kemi parasysh? Në qoftë se do të marrim, të bëjmë një analizë nga viti 1994 e deri në vitin 2014, na rezulton se ata që kanë punuar, kanë zhvilluar aktivitet bujqësor dhe blegtoral dhe që kanë pasur mundësi dhe të ardhura që të paguanin këtë kontribut që siç u tha, ka qenë i vogël, sepse subvencionohet pjesa tjetër nga shteti, kanë qenë rreth dy nga dyqind e nëntëdhjetë mijë deri në treqind e dhjetë mijë.

Aktualisht, sipas analizës më të fundit, në fund të vitit 2013 dhe në fillim të vitit 2014, ne kemi rreth njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë persona që zhvillojnë aktivitet bujqësor dhe blegtoral dhe kanë mundësi që të paguajnë kontributin, sepse një pjesë janë me ndihmë ekonomike dhe përjashtohen, një pjesë tjetër mund të kenë edhe problematika ose dhe punësime të tjera dhe përgjithësisht nuk afrohen. Kështu që, duke qenë se në reformën e pensioneve, në një nen të saj, nuk e mbaj mend tamam por besoj në nenin 96, është përcaktuar që ky do të jetë viti i fundit që këta persona mund të paguajnë kontribute sipas masës kontribut që ka qenë. Atëherë, është dhe rasti i fundit që këtyre njerëzve që tashmë i kanë zgjidhur disa probleme të vetëpunësisë etj, etj, tu lejohej që të paguajnë kontribute duke i përjashtuar nga kamat-vonesa. Ne presim që ata që duhet të paguajnë kontribute, janë rreth njëqind e shtatëdhjetë mijë, në normale domethënë por faktikisht, besojmë se jo të gjithë do të afrohen sepse kjo është një eksperiencë e provuar, por sidoqoftë pritshmëria është e madhe.

Që ditën që u miratua ky projektligj nga Këshilli i Ministrave për tu sjellë në Kuvend dhe duke qenë se njerëzit i kanë ndjekur punimet në seancat e grupeve, në seancat e komisioneve, ka pasur një interesim shumë të madh nga të gjithë personat për të ardhur pranë sporteleve të sigurimeve shoqërore për të marr urdhër-veprimet për tu sqaruar për gjithë bazën e të dhënave që ata kanë ose për llogaritë që kanë me sigurimet shoqërore, derdhjen e kontributeve dhe sinjerisht sot ju them që jemi shumë entuziast që ky projekt-ligj dhe kjo falje do të jetë shumë efektive. Natyrisht që pagesat ende nuk kanë filluar sepse s'mund të fillohet nga pagesat, por të gjithë urdhër-veprimet janë bërë gati për tu dhënë. Instituti i

sigurimeve shoqërore ka ndërtuar një evidencë me katër zëra kryesorë për ta ndjekur dhe në mënyrë të përditshme se cilët janë njerëzit që janë kontaktuar nga inspektorët dhe janë dyqind e pesëdhjetë inspektorë të shpërndarë në gjithë komunat e vendit që janë të atashuar, plus një pjesë e mirë e stafit të drejtorive rajonale, e stafit drejtues dhe të institutit. Pra, do të evidentojmë një për një cilët janë njerëzit që janë kontaktuar për ti sqaruar lidhur me këtë problem.

E dyta, cilët janë njerëzit që kanë marrë urdhër-veprimi për të paguar, cilët janë ata që i kanë paguar dhe në fund pastaj janë të ardhurat ditore dhe progresive, me qëllim që të ndjekim efektivitetin e zbatimit të këtij projekt-ligji deri në datën 31 i dymbëdhjeti? Kjo është kryesorja. Tani, në përgjigje të pyetjes suaj, mund të them dhe diçka. Ka shumë njerëz që kanë banuar në fshat, kanë jetuar aty, kanë zhvilluar aktivitet bujqësor dhe blegtoral por faktikisht sot mund të ndodhen, janë në qytet tjetër ose mund të kenë shkuar dhe në emigracion. Edhe zoti ministër i punës e ka bërë disa herë të qartë por edhe ne po e themi për së dyti. Këta njerëz, për atë periudhë që kanë zhvilluar aktivitet bujqësor dhe nuk kanë paguar kontribute, kanë të drejtë që të shkojnë në rrethin e tyre sepse aty do të paraqesin dokumentacionin për tokën, për periudhën e banimit etj, etj dhe kanë të drejtë që ti blejnë kontributet e asaj periudhe pa paguar kamat-vonesën. Po marr, në censin e nevojshëm mund të them edhe një shembull, po them, një njeri që ka ardhur nga Korça dhe banon sot në Tiranë, por në Korçë nuk ka paguar kontributet e vitit, po themi 2000 deri 2004, mund të shkojë atje të paraqitet, të paraqesë dokumentacionin që parashikon Vendimi i Këshillit të Ministrave, numër 1114 që nuk është shumë i komplikuar dhe pastaj e ka rrugën të hapur në zbatim të këtij ligji për të paguar kontributet me kamat-vonesë. Pak a shumë këto ishin problematikat. Lidhur me sektorë të tjerë ka pasur disa ndërhyrje edhe sidomos ndonjëherë është thënë dhe për fasonët pse të mos futen në këtë. Unë nuk kam ndonjë evidencë konkrete që të them sa ndërrmarje fasoniste janë që kanë paguar vetëm principalin dhe kanë kamat-vonesa apo... Ne, mund të them këtë gjë, që borxhet e subjekteve juridike dhe fizike ndaj sigurimeve shoqërore, përjashtuar të vetëpunësuarit në bujqësi janë shumë të mëdha, me thënë të drejtën po arrijnë rreth dhjetë miliard lekë, të reja flas, janë një problematik dhe një shqetësim i madh. Ka një ndërhyrje mjaft intensive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sepse ato i administrojnë kontributet. Ky ligj që është paraqitur, është paraqitur sepse këto kontribute administrohen nga sigurimet shoqërore dhe këta janë të vetëpunësuar, kurse të gjithë të tjerët, po marrim edhe punonjësit e fasonëve, ata quhen të punësuar, janë punëmarrës edhe nëse do të ketë një çështje të kësaj natyre, është Ministria e Financave që mundet të

marrë nisma konkrete. Nëse duhet që ne të raportojmë ose të sjellim një informacion lidhur me detyrimet që kanë subjektet juridike dhe fizike ndaj sigurimeve shoqërore për kontribute të papaguara, këtë mund ta bëjmë kur të dëshironi ose kur të na i caktoni.

Faleminderit, për përgjigjet!

Zoti Qefalia ka kërkuar fjalën për pyetje.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do isha i interesuar, sikur përmendët një shifër, rreth njëqind e shtatëdhjetë mijë veta janë punësuar në bujqësi, ish të vetëpunësuar në bujqësi të cilët nuk kanë derdhur kontribute. Në fakt kam dëgjuar këto ditë dhe opozitën dhe thuhet sikur kjo po bëhet për të mbushur arkën e shtetit, meqenëse ne jemi në situatë krize. Do isha e interesuar, si një fermer i zonës ku unë administroj çfarë dokumentacioni do të paraqes unë në qendër dhe në vendin ku është caktuar për të derdhur këtë shumë parash që mbulon vitet e punës në bujqësi? Pretendimet e shumë individëve mund të jenë të mëdha, siç e thatë ju, mund të ketë lëvizje nga fshati në qytet apo në emigrim, të cilat e bëjnë të pamundur për t'u njohur drejtpërdrejt me informacionin.

Edhe pyetja që bëri zonja Hysi ka të bëjë me vetë informimin që po marrin banorët e këtyre zonave. Nuk është e mjaftueshme vetëm me 240 vetë që keni ju të shpërndarë në të gjitha komunat e vendit, por një fushatë sensibilizuese ndoshta edhe mediatike do të bënte që të rriste në mënyrë të dukshme numrin e këtyre njerëzve të cilët kërkojnë të përfitojnë nga falja e kamatëvonesave.

Astrit Kuka – Unë mund të përgjigjem për mënyrën e komunikimit pastaj për pyetjen për dokumentacionin, përgjigjet zoti Emini.

Për sa i përket komunikimit si pjesë e reformës së pensioneve, bashkë me Bankën Botërore ne po dizenojmë një fushatë komunikimi, e cila do të fillojë në dhjetor dhe do të shtrihet edhe në tre muajt e parë të vitit të ardhshëm, e cila, përveç mobilizimit të strukturave të sigurimeve shoqërore, do të ketë edhe një fushatë të gjerë medietike nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me emisione televizive, me pamflete, me spote publicitare të cilat do t'i adresojmë pikërisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Gjatë muajit dhjetor do të bëhet një fushatë shumë e gjerë mediatike nga Ministria e Mirëqenies Sociale për reformën në përgjithësi, dhe duke targetuar në veçanti faljen e kamatëvonesave në mënyrë që të shpjegohen sa më qartë të vetëpunësuarit në bujqësi dhe të nxiten të bëhen pjesë e skemës.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Ali Emini – Pyetja ime: është si do të organizohet komunikimi, cilat janë dokumentet për 173 mijë e 400 persona?

Ne themi që, sipas bilancit të popullsisë agrare, që zhvillon aktivitet bujqësor dhe blegtoral, sot në të gjitha rrethet e vendit kryejnë aktivitet 173 mijë persona.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këta persona nuk është se nuk kanë pagur fare, por në harkun e 20 vjetëve kanë boshllëqe në vitet që kanë mbuluar me kontribut.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Të rinjtë janë të rinj dhe ata kanë të drejtën e tyre për të filluar me pagesë, do të thotë, se jemi në kushtet kur unë mbase nuk e shpjegova mirë, janë 173 mijë që kanë mundësi dhe të ardhura për të paguar, jo se nuk kanë paguar fare. Faktikisht çdo vit janë mbledhur nga bujqësia rreth 3 miliardë lekë kontribute.

Çfarë dokumentesh duhen? Është e përcaktuar në vendimin e nr. 1114 të Këshillit të Ministrave. Janë tri dokumente: e para, është vërtetimi për pronësinë mbi tokën, sepse duhet objekti ku punon. E dyta, është një vërtetim nga gjendja civile e zonës ka banuar dhe e treta është një vërtetim nga organet e pushtetit lokal nga komuna që tregon se ka zhvilluar aktivitet bujqësor dhe blegtoral. Organet e pushtetit lokal janë të mirënjohura me këto lloj formatesh. Ata që kanë një dosje i kanë këto dokumente dhe nuk kanë nevojën e përsëritjes.

Ne themi që përveç 250 inspektorëve kemi shpërndarë të gjithë stafin drejtues të drejtorive rajonale dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore në të gjithë rajonet e vendit për të kontaktuar me mediet. Gjithashtu, me miratimin e projektligjit kemi bërë gati një fletëpalosje që do të shpërndahet.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ne mendojmë që me dosje aktuale janë 150 mijë, prandaj dhe në relacion kemi parashikuar që 20 mijë do të jenë të rinj. Nxitja kryesore e kësaj falje është edhe kjo që një njeri do të futet në rrugën e pagesës së kontributeve, pastaj është një skemë që mund të vazhdohet dhe kjo do të japë efektivitetin edhe për të ardhmen.

Fatmir Xhafaj –Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje të tjera.

Kisha unë një pyetje për çështjen e afatit te neni 3. Kjo më shqetëson.

Jeni dakord në parim? Dakord.

Vazhdojmë tani me diskutimet.

A ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë fillojmë me diskutimet nen për nen.

Fillojmë me nenin 1.

Zonja Hysi, keni pyetje për nenin 1?

Vasilika Hysi – Unë kam një pyetje për shprehjen që përdoret “për periudhat e kaluara”, a mundet një person që të fillojë të paguajë që nga viti 1992 apo, sikurse thatë ju, nga viti 2000?

Ali Emini - Skema e sigurimeve shoqërore në fshat ka filluar më 01.10 1993. Por faktikisht ligji parashikon periudhën nga 01.01.1994 dhe deri në vazhdim.

Fatmir Xhafaj – A ka diskutime të tjera? Nuk ka.

A jeni dakord me nenin 1?

Dakord.

Neni 2.

Një shpjegim nga zoti Emini, më të detajuar për kuptimin e këtij neni?

Vasilika Hysi – Zoti Emini, këtu thuhet se kamatëvonesat dhe gjobat e papaguara falen edhe për kontributet e sigurimeve shoqërore që janë paguar. Çdo të thotë kjo? Përderisa ai i ka paguar, çdo të thotë kjo?

Ali Emini – Sigurimi shoqëror në fshat është i detyrueshëm. Si procedurë që është parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave është që çdo person paraqet dokumentet, i jepet një urdhër veprimi, është një dokument teknik që i përlllogaritet sa është shuma e kontributit që duhet të paguajë për periudhën që duhet mbuluar. Ka shumë raste që i vetëpunësuar shkon dhe paguan në bankë principalin, sepse atë e ka të lirë dhe nuk paguan kamatëvonesën. Kështu që ne kemi kamatëvonesa të evidentuara si të papaguara dhe, me thënë të drejtën, ky nen bën mirë edhe për këtë gjë, pasi kjo punë mund të ndodhë edhe sot që diskutohet projektligji, ata shkojnë dhe paguajnë principalin dhe faktikisht nuk paguajnë kamatën dhe natyrisht, pastaj kamata është e llogaritur, por falet edhe shuhet.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A jeni dakord me nenin 2? Dakord.

Neni 3. Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Mos duhet korrigjuar fjalja “mund të ushtrohet deri më 31 dhjetor 2014”? Sepse ju thoni “E drejta e personave të vetëpunësuar në bujqësi që përfitojnë nga falja

e kamatëvonesave dhe gjobave në përputhje me dispozitat e këtij viti, mund të ushtrohet deri më 31 dhjetor 2014” Në ligj nuk mund të thuhet “mund”, ose ushtrohet ose nuk ushtrohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Shteti të jep të drejtën, pastaj ai as paguan as e ushtron, zgjedhja është e tij.

Bardhylka Kospiri – Dakord. E pranojmë.

Fatmir Xhafaj – A ka pyetje të tjera?

Zoti Manja për nenin 3.

Ulsi Manja – Unë për nenin 3 më tepër dua një sqarim nga përfaqësuesit. Në përgjithësi në muajin nëntor-dhjetor ne presim emigrantët. Sigurisht ky projektligj merr në konsideratë edhe personat e vetëpunësuar në bujqësi, por që aktualisht ndodhen në emigrim. Ky nen, në konceptimin tuaj, një person e ushtron të drejtën brenda datës 31 dhjetor, a ka të drejtë t’i dërdh paratë, pra kontributet edhe në janar edhe në shkurt? Me çfarë lidhet data 31 dhjetor 2014, me të drejtën e ushtrimit, pra të kërkesës për të paguar apo edhe pagesa duhet të jetë e ezauruar deri mesnatën e 3.12.2014.

Fatmir Xhafaj – Është fjala vetëm për kamatëvonesat.

Ulsi Manja – Jo edhe për ata që nuk kanë paguar.

Fatmir Xhafaj – Është e saktë kjo, “E drejta e personave të vetëpunësuar në bujqësi përfitojnë nga falja e kamatëvonesave” nuk paguajnë gjë, por aty deri më 31 unë t’i legalizoj kamatëvonesat dhe gjobat, nga data 1 e tutje nuk t’i njoh më, do t’i paguash”. Kjo është logjika e këtij neni. Kurse detyrimin ai mund ta paguajë edhe me 1 janar edhe në shkurt. Apo e kam gabim? Kjo është logjika?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ali Emiri - Ky ligj i kombinuar me ligjin e sigurimeve shoqërore, ku 16 nenet e para flasin për kontributet dhe për procedurën dhe natyrisht edhe me dispozitat e tjera ligjore, ka në parim këtë gjë, që kontributi mund të regjistrohet dhe vjetërsia e punës mund të regjistrohet e përfunduar, kur kontributi është paguar dhe ka kaluar në llogari të sigurimeve shoqërore. Çdo njeri që i paguan kontributet deri më 31.12.2014, i paguan pa kamatëvonesë, më pas as nuk i parashkruhet e drejta, ai do të paguajë me kamatë.

Për sa u përket emigrantëve, ka një diferencim, sepse ka emigrantë sezonalë që faktikisht zhvillojnë aktivitet bujqësor dhe blegtoral në Shqipëri, por ndodh që shkojnë e punojnë dy-tre muaj jashtë. Këto janë pranuar, sepse këto faktikisht janë punonjës që rrinë në Shqipëri e zhvillojnë aktivitetin e tyre punojnë në bujqësi dhe natyrisht lejohet që të

paguajnë kontribute me këtë masë të diferencuar. Kurse nëse një emigrant punon të gjithë kohen jashtë, ai ka një skemë tjetër, ka skemën e sigurimit vullnetar që mund të paguajë dhe të blejë periudha kontributesh, por këtu kontributet nuk janë të subvencionuar nga shtetit, sepse aktualisht, megjithëse kontributi në fshat është rreth 330 mijë ose 33 mijë lekë të rinj në vit shteti paguan gati mbi 45% të shumës që i bashkohet me këtë dhe quhet vit siguri.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Për të qenë më konkret kam një tabelë, këtu përpara. Nëse njëri nuk ka paguar 20 vjet, pra nga data 1.02.1994 dhe deri më sot, duhet të paguajë 204948 lekë kontribut dhe i falet 120809 lekë kamatë. Pra, me 2 milionë lekë të vjetra, ndërkohë që i falen 1 milion e 200 mijë. Ne këto i kemi botuar edhe në gazetë dhe me thënë të drejtën kemi qenë pak të shtrënguar. Me miratimin e ligjit do të ecim më shpejt.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Keni një gjë parasysh, siç është shkruar ligji, nëse do të shkojë në gjykatë, deri në datë 31 dhjetor falen të gjitha llojet, ka paguar apo nuk ka paguar ai kamatë vonesat, nga data 1 e tutje, ai mund të shkojë e t'i paguajë dhe nuk paguan kamatëvonesat. Kështu e keni ndërtuar ligjin ju. Po që se këtë do ta kishit ndërtuar ndryshe, atëherë mund ta lidhnit me pagimin e detyrimit, por ky ligj harrojeni se do të jetë ashtu siç është në mendjen tuaj, do të jetë siç thonë kolegët. Kështu siç e keni shkruar, dhe keni bërë mirë, edhe ne, dakord jemi, por në qoftë se në mendje keni që nëse ai e paguan detyrimin në janar do të paguajë edhe kamatëvonesat, pra gjrobat e këtyre 10 vjetëve nuk ndodh kjo me këtë ligj që keni shkruar. Dhe është shumë mirë kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dhe e dyta, që është shumë e rëndësishme, është fakti që kolegët kanë një shqetësim që do të duhet t'ia thoni edhe ministrit, do t'ia themi edhe ne në seancë. Kjo kërkon një fushatë të jashtëzakonshme, sepse me këtë reformën e pensioneve ministri ose do të mbetet ministër edhe me sukses ose do të "kryqëzohet". Unë i uroj të parën, sepse është reformë shumë e rëndësishme dhe do të shohim efektin.

Po. Neni 3 kaloi.

Neni 4. Dakord. "Kamatëvonesat dhe gjrobat për kontribute për sigurimet e ndryshme shoqërore të *papaguara* nuk kthehen". Dakord.

Neni 5. Dakord.

E mbylлим këtu.

Po, zonja zëvendësministre.

Bardhylka Kospiri - Ishim më parë edhe në Komisionin e Ekonomisë, dhe te neni 5 relatori kishte bërë një propozim që të hyjë në fuqi menjëherë. Ne e pranuan dhe do t'ju ftonim edhe ju sepse do të duhet të ecim më shpejt.

Fatmir Xhafaj –Por ka një kushtëzim hyrja në fuqi menjëherë, sepse duhet pëlqimi. (Ndërhyrje pa mikrofon).

Faleminderit, zonja zëvendësministre, faleminderit zotërinj që ishit të pranishëm!

Siç e patë mbështetjen e komisionit e keni pa fund, por do të keni edhe monitorimin e deputetëve për këtë hap. Siç ju vlerësojmë edhe do t'ju monitorojmë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 12.11.2014; ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutim i Projektbuxhetit 2015 për Ministrinë e Drejtësisë

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Nard Ndoka, Silva Caka dhe Tahir Muhedini.

Mungojnë:

Edi Paloka, Kastriot Islami, Armando Prenga, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Mhill Fufi, Mark Frroku, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Tom Doshi, Pirro Lutaj dhe Eduard Halimi.

Të ftuar:

Nasip Naço – ministër i Drejtësisë

Llambriola Misto – sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë

Petrit Baku – drejtor

Qausar Rama – përgjegjës Sektori

Erjon Luçi – zëvendësministër i Financave

Gelardina Prodani – sekretare e Përgjithshme

Mimoza Dhëmbi – drejtore e Përgjithshme e Buxhetit

Fran Brahimi – Drejtoria e Monitorimit dhe Zbatimit të Buxheti

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me Ministrinë e Drejtësisë, për buxhetin.

Fjalën e ka ministri i Drejtësisë.

Mirëdita, zoti Ministër!

Po, edhe Ministria e Financave.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti kryetar!

Qeveria shqiptare për vitin 2015 ka një plan dhe një program ambicioz në lidhje me projektbuxhetin. Sigurisht që të gjitha ministritë, por edhe Ministria e Drejtësisë në çdo rast për shkak të programit dhe ambicieve që ka për të zhvilluar më tej reformat, asnjëherë nuk kanë qenë e kënaqur dhe nuk ka për të qenë e kënaqur me miratimin e këtij projektbuxheti që është përcaktuar për Ministrinë e Drejtësisë.

Ajo që mund t’ju them në vija të përgjithshme është që rritja e financimit të brendshëm duke e krahasuar me vitin 2014 është 13,7% më e madhe se në vitin 2014. Them që ky projektbuxhet është ambicioz dhe rritja është e konsiderueshme, pavarësisht nga nevojat që ne kemi, dhe nevojat më të mëdha janë për sistemin *penitenciar*, për të cilin çdo vit nga buxheti i shtetit jepen shuma të konsiderueshme. Asnjëherë për shkak edhe të një politike të zhvilluar në vitet e fundit për të zbatuar dhe për të pasur një shtet ligjor sigurisht që në këtë drejtim janë kërkuar për të hapur edhe disa burgje të reja, të cilat kanë vite që janë financuar nga projekte të Bashkimit Europian dhe kosto lokale TVSH-je dhe një pjesë e financimit ka qenë nga buxheti i shtetit. Sigurisht që ne kemi kërkuar më shumë, por jemi të ndërgjegjshëm që kaq kanë qenë mundësitë që janë vënë në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë.

Në lidhje me ambiciet që ka pasur Ministria e Drejtësisë për reforma strukturore, për të shtuar edhe agjenci të tjera që do t’u vijnë në ndihmë reformave në drejtësi, kemi kërkuar një shtim të një numri të konsiderueshëm punonjësish, por mbi 400 punonjës janë shtuar në buxhetin e shtetit për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2015. Një pjesë e konsiderueshme e numrit të këtyre punonjësve, janë për hapjen e burgut të ri të paraburgimit në Berat dhe Fier. Në tratativat që kemi bërë me Ministrinë e Financave kemi parashikuar edhe për burgun e Shkodrës, që është parashikuar të mbarojë në muajt prill – maj, të shtojmë edhe fonde të tjera për të rialokuar dhe për të shtuar numrin e punonjësve dhe për të vënë në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë dhe sistemin penitenciar.

Duke folur për shpenzimet koherente, mund të them, që shuma e vënë në dispozicion nga buxheti i vitit të kaluar 2014 është rreth 12 milionë euro më shumë, që është për paga shpenzime të ndryshme.

Kërkesat e ministrisë kanë qenë më të larta, por besoj se ne me vënien në dispozicion të këtij projekti, ne si Ministri e Drejtësisë, themi që t'i plotësojmë nevojat duke marrë parasysh edhe për 6 mujorin e dytë të vitit 2015 që ka të bëjë me burgun e Shkodrës.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, jam i hapur nëse do të keni pyetje konkrete.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Relator është zoti Fino.

Fillojmë me pyetjet. Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam disa pyetje duke marrë shkas nga roli që ka luajtur Kuvendi gjithë vitit 2014 në miratimin e shumë ligjeve të reja të cilat janë përgjegjësi e institucionit që ju drejtoni për t'i zbatuar.

Pyetja e parë ka të bëjë me ndihmën juridike. Ne kemi kaluar ligjin për ndihmën juridike dhe në këtë ligj kemi propozuar forcimin e zyrave vendore. Buxheti i vitit 2015 i përmbush nevojat që ndihma juridike në nivel vendi të jetë efektive dhe të mos mbetet në letër?

Pyetja e dytë ka të bëjë me sistemin e burgjeve. Të them të drejtën nuk ndjehem mirë që në Shqipëri ne vazhdojmë të hapim burgje të reja, ndërkohë që mund të kishte një politikë tjetër penale, sidomos për trajtimin e të miturve, të cilët janë problem. Kemi 20 vjet që nuk kemi një qendër edukuese për trajtimin e të miturve që kryejnë vepra penale dhe nuk kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale ose të të miturve për të cilët jepen masa edukative. A keni planifikuar ju në buxhetin e vitit 2015 zbatimin e nenit 46 të Kodit Penal për masat edukative të të miturve dhe ngritjen e institucionit për edukimin e të miturve që nuk kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe për të cilat gjykata vendos masë edukative?

Pyetja e tretë ka të bëjë me zbatimin ligjit të ri “Për publikimet zyrtare”. Unë shoh që në ligjin e ri ne kemi planifikuar ndryshime dhe detyrime shumë të mëdha për Qendrën e Publikimeve Zyrtare. Më lejoni të përfitoj nga rasti që ju sot jeni i pranishëm, por sot në librarinë e Librit Universitar nuk gjenden të botuara kodet kryesore dhe sot studentët, gjyqtarët, prokurorët nuk kanë botimin zyrtar të kodeve dhe të përmbledhësve të legjislacionit, që është detyrë e institucionit tuaj dhe jo e kompanive private që i shesin me dyfishin ose trefishin e tyre. Unë dua të di se çfarë ka ndodhur? A janë planifikuar që në vitin 2015 e vetmja qendër që duhet të publikojë botimet zyrtare, legjislacionin me të cilët duhet të pajisemi dhe ne, që nuk pajisemi sot ne deputetët, është vetëm ministria, jeni ju?

Këto janë 3 pyetjet kryesore që unë kam.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Fjalën e ka ministri.

Nasip Naço - Faleminderit, zonja Hysi!

Unë do të përgjigjem në lidhje me pyetjen e dytë. Personalisht, por dhe ju dhe kolegë të tjerë asnjëherë nuk kemi qenë dakord që të kemi një politikë agresive në drejtim të mbushjes së burgjeve. Pra, vitin e kaluar dhe në rekomandimet që i kemi dërguar Prokurorisë së Përgjithshme në zbatim të ligjit kemi kërkuar që të ketë një politikë ndryshe, pra të ashpërsohet politika e dënimit për veprat penale që parashikojnë mbi 5 vjet dhe të ketë një politikë ndryshe me dënime alternative për vepra penale që parashikohen deri në 5 vjet burgim, sigurisht duke pasur dhe disa prioritete të cilat janë lançuar dhe kohët e fundit, siç është vjedhja e energjisë elektrike kur dëmi në buxhetin e shtetit është mbi 150 milionë euro, pra, që nuk arkëtohen për shkak të vjedhjeve, humbjeve në rrjet ose të defekteve të ndryshme. Sigurisht që në këtë rast nuk do të ketë amnisti për këta vjedhës të energjisë elektrike dhe sigurisht që do të ketë një politikë më agresive në këtë drejtim. Në lidhje me të miturit unë besoj se gati mbi 30 milionë euro që parashikon buxheti i shtetit shkojnë vetëm për sistemin peniteciar. Po të ishte për kërkesat dhe nevojat që ka Ministria e Drejtësisë, do të duheshin edhe 19 milionë euro të tjera. Sigurisht jemi të ndërgjegjshëm që kaq kanë qenë mundësitë për vitin 2015 nga gjendja që trashëguam për vitin 2013 dhe vitin 2014. Nëse do t'i kishim këto lekë, sigurisht që do t'i kishim parashikuar dhe janë me dhjetëra projekte që ne i kemi gati, i kemi kërkuar, por kaq kanë qenë mundësitë për të financuar në drejtim të sistemit peniteciar.

Në lidhje me dy pyetjet e tjera, që kanë të bëjnë për ndihmën juridike, sigurisht që kemi kërkuar për të shtuar dhe për të hapur zyrat rajonale. Besoj se për parashikimin në total, fondet që jepen për Ministrinë e Drejtësisë do të jenë në konsideratë për ndihmën juridike, por dhe për Qendrën e Publikimeve Zyrtare për të plotësuar ato nevoja dhe ato ndryshime ligjore që ne bëmë në vitin që jemi për të pasur një qendër publikimesh ku dhe të gjitha publikimet e tjera që deri dje ishin nëpër gazeta të tjera lokale, sot do të bëhen nga kjo qendër. Kërkesat tona kanë qenë më të mëdha, por kaq kanë qenë mundësitë. Unë jam i ndërgjegjshëm për mundësitë që ka pasur qeveria në këtë projektbuxhet për përmirësimin e drejtësisë. Në ditët në vazhdim bashkë me përfaqësues të Ministrisë së Financave ne do të vazhdojmë dhe për disa projekte të tjera. Do të kemi mirëkuptimin, por edhe mundësinë për

të na dhënë fonde dhe sigurisht që jemi të hapur të zhvillojmë dhe projekte të tjera të cilat i kemi gati.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje të tjera? Po, zoti Manja.

Ulsi Manja – Zoti Ministër,

Unë kam një pyetje lidhur me buxhetin. Siç dihet, tashmë ne kemi thënë që ky vit do të jetë viti i reformës në sistemin e drejtësisë. Sigurisht kjo reformë ka shpenzime, ka kosto financiare dhe Ministria e Drejtësisë do të jetë bërthama e kësaj reforme. A është planifikuar në buxhetin tuaj kjo kosto financiare lidhur me reformën në sistemin e drejtësisë, pra me reformën që ju pritët në sistemin e drejtësisë? Ka shtesë financiare?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Naço.

Nasip Naço – Pak më parë zonja Hysi bëri një pyetje në lidhje me sistemin penitenciar dhe në lidhje me ndërtimin e burgjeve të reja. Unë besoj se ne nuk kemi ndërmend të propozojmë ndërtimin e burgjeve të reja të rristrukturojmë 313, që është ndërtuar në vitin 1937 dhe besoj mbarimin e këtyre që janë me projektet e BE-së. Ajo që ne kemi kërkuar dhe kërkojmë vazhdimisht është dixhitalizimi i gjithë sistemit dhe të gjitha projektet tona kanë shkuar dhe do të shkojnë në drejtim të dixhitalizimit të sistemit gjyqësor duke filluar që nga arkiva gjyqësore që shumë shpejt do të jetë në një qendër të veçantë për arkivimin dhe dixhitalizimin e të gjitha vendimeve nga viti 1945 dhe këtej për t'i pasur në një qendër, për t'i dixhitalizuar dhe për t'i pasur në dispozicion, duke filluar që nga kartelizimi i të gjithë të dënuarve, duke filluar me sistemin **ICMIS** në gjykata. Pra, pjesa më e madhe e projekteve, përveç atyre që janë në vazhdim të ndërtimit dhe përfundimit të burgjeve, ndërsa pjesa tjetër e të gjitha projekteve do të shkojnë në drejtim të dixhitalizimit të sistemit gjyqësor.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Caka.

Silva Caka – Në fakt, zoti ministër e preku pak a shumë pyetjen.

Ju, zoti Ministër, po na thoni se nuk do të ketë rikonstruksione të kësaj kategorie të institucioneve, domethënë të burgjeve të vjetra. Ne ishim dje për vizitë në paraburgimin 302 dhe ky institucion priste që të kishte një zë në këtë projektbuxhet të vitit 2015. Kjo do të thotë

se nuk do të ketë rikonstruksione? Projektbuxheti i ka përqendruar të gjithë zërat e tij te dixhitalizimi?

Mund të na i përmendni të gjitha zërat që nuk janë përmbushur nga ky projektbuxhet që ju keni kërkuar, por projektbuxheti nuk i parashikon ose i ka financuar me një shumë më të vogël?

Fatmir Xhafaj -Faleminderit!

Nasip Naço – Unë besoj se fola qartë, rritja, duke e krahasuar me 2014-n është 12 milionë euro më tepër që shkojnë për shpenzime. Sigurisht nëse do të na jepej mundësia dhe do të kishim të gjitha fondet do të donim dhe 19 milionë euro të tjera që pjesa më e madhe do të vinte sigurisht për rikonstruksionin e burgjeve ekzistuese. Unë përmenda burgun 313 që është ndërtuar në vitin 1937,në mos gaboj dhe ka një projekt për rikonstruksionin e këtij burgu. Sigurisht që ka dhe projekte të tjera për të bërë ndryshime brenda këtij burgu, pasi duke pasur afër dhe gjykatën, ulen kostot e tjera. Është menduar që më mirë të financohet te burgu 313, sesa në rrethe të tjera dhe në largësi ku ne dimë që pjesën kryesore e zë gjykata e rrethit Tiranë dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda. Sigurisht që ne jemi të ndërgjegjshëm që gjendja në sistemin e burgjeve duhet të ndryshojë, por më mirëkuptoni dhe ju që keni parë dje, gjërat nuk bëhen në një ditë.

Në vitet e fundit janë investuar rreth 70 milionë euro vetëm për ndërtimin e burgjeve të reja. Sigurisht që burgje të reja nuk do të ndërtohen dhe pjesa tjetër e fondeve që do të ketë në dispozicion Ministria e Drejtësisë do t'i adresojë për përmirësimin e kushteve qoftë në burgun 302, 313 apo dhe 325 që është burgu i grave ose ai që është në Kavajë për persona të mitur. Sigurisht që kanë nevojë për ndërhyrje rrënjësore në këto burgje, por unë jam i vetëdijshëm që kaq janë mundësitë kur them se duke krahasuar vitin e kaluar janë shtuar mbi 10 milionë euro për investime, krahasuar me vitin 2013 dhe në vitin 2014 dhe vitin 2015 shtohen edhe 12 milionë euro të tjera. Jam i vetëdijshëm që kaq kanë qenë mundësitë. Besoj se ju si Komisioni i Ligjeve do të ndikoni në mënyrë pozitive te Ministria e Financave, ne jemi të hapur që t'i pranojmë të gjitha fondet, edhe 19 milionë euro të tjera.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia - Faleminderit!

Zoti Ministër, e ndoqa me vëmendje fjalën tuaj që në fillim dhe më duket një shenjë pesimizmi që as kam qenë, as do të jem, as jam i kënaqur me buxhetin. Natyrisht kjo është në sajë të ambicieve që keni ju për ta transformuar sistemin e drejtësisë. Unë do të isha i

interesuar, zoti Ministër, sepse reforma në sistemin e drejtësisë nuk është të ndërtosh vetëm burgje dhe nuk është mirë për një shtet të krenohemi që po ndëtojmë burgje. Për këtë projektbuxhet të këtij viti do të isha i interesuar nëse është menduar për t'u shërbyer qytetarëve për krijimin e zyrave të pritjes qoftë për dëshmitë e penaltetit, qoftë për informacionet e tyre, për marrjen e dokumenteve të pronësisë nëpër hipoteka. A ka një buxhet që u paraprin këtyre apo është menduar vetëm me këtë rindërtim, rikonstrukcion dhe nuk është vetëm kjo reforma që presin shqiptarët?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zoti Ministër.

Nasip Naço – Unë personalisht thashë nuk jam i kënaqur, por duke krahasuar që në 50 milionë, mbi 30 milionë euro, që gati është buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, vetëm për sistemin penitenciar besoj që të gjithë jemi të ndërgjegjshëm dhe të parët duhet të mendojë Ministria e Drejtësisë për të kryer reforma që ulin shpenzimet në buxhet. Vitin e kaluar Ministria e Drejtësisë ka dalë me një program konkret dhe ne kemi kërkuar dhe po fuqizojmë shërbimin e provës duke shkuar te dënimet alternative. Besoj që fuqizimi i shërbimit të provës, hapja e zyrave të reja, shtimi me personel në të gjitha gjykatat e vendit besoj se do të ulë shpenzimet në sistemin penitenciar duke investuar gati 1 milion euro për shërbimin e provës dhe do të kursejmë gati 10 milionë euro të tjera që janë parashikuar në buxhet. Pra, Ministria e Drejtësisë e ka menduar, ka kërkuar në projektbuxhet, është shtuar numri i personelit për të punuar në shërbimin e provës, sigurisht që kërkon dhe fonde të tjera, të cilat ne brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë duam ta fuqizojmë këtë shërbim.

Unë personalisht nuk jam dakord që ne të ndëtojmë vetëm burgje. Ju jeni të ndërgjegjshëm që vitin e kaluar kemi bërë disa ndryshime dhe në Kodin e Procedurës Penale. Ndryshimet shumë shpejt do të vijnë në projektligjin “Për shërbimin e provës” për të pasur dënime të tjera alternative, për të pasur një politikë tjetër të dënimit në vendin tonë. Unë jam i ndërgjegjshëm që nuk na shtoni fonde, por nëse ne sjellim projektligjin dhe bashkë me ju e kalojmë në Kuvend kjo do të jetë ndihma më e madhe që i jepni ministrit të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë. Pra, një projektligj që shumë shpejt do ta keni në dispozicion dhe besoj që me oponencën tuaj, me përmirësimet tuaja, nëse ne e miratojmë shumë shpejt, do të ndjekim një politikë ndryshe të dënimit në vendin tonë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Zoti Ndoka ka kërkuar fjalën.

Nard Ndoka – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Ministër,

Unë kisha një shqetësim lidhur me buxhetin për burgjet. Dihet se ka një mbipopullim në kushtet aktuale, por ka dhe një slogan të shpallur nga Kryeministri, të gjithë në burg nëse shkelet semafori, për ndërtimet pa leje, kur nuk paguan faturën e energjisë elektrike. Pra, është një shtim jashtë grafikave ose ecurive ndër vite. A është marrë parasysh te buxheti nga qeveria, nga ministria juaj një vërsim i tillë?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Ministër.

Nasip Naço – Unë nuk besoj që qeveria ose Kryeministri përdor slogane në praktikën e vet. Pak më parë thashë se dëmi që i shkaktohet buxhetit të shtetit nga vjedhja ose humbja në rrjet e energjisë elektrike është mbi 150 milionë euro. Sigurisht që e deklaroj dhe një herë, nga Ministria e Drejtësisë nuk do të kërkohet dhe nuk do të ketë amnisti për vjedhësit e energjisë elektrike, por sigurisht këtu përfitoj nga rasti t’u bëj thirrje të gjithë qytetarëve, të gjithë biznesmenëve që të paguajnë energjinë elektrike, të jenë korrektë me shtetin, ndryshe shteti është në këmbë 24 orë në ditë dhe do të tregojë që të gjithë ata që vjedhin, siç vidhet në raste të tjera do të përgjigjen. Për këtë buxhet të vitit 2015 janë planifikuar dhe ndërtimi i burgjeve të reja. Të gjithë ata që shkelin ligjin përveç dënimit alternativ, kryerjen e një pune të detyrueshme, janë marrë masat për t’i mbajtur të siguruar dhe sipas kushteve bashkëkohore që kanë edhe vendet e BE-së, por që të vjedhësh mbi 150 milionë euro dhe ne të trembemi se hyjnë 10 ose 20 veta në burg, ky nuk është slogan, por besoj që edhe ju duhet të jepni ndihmën dhe kontributin tuaj, të mbështesni qeverinë në këtë drejtim. Çdo nismë i shërben stabilitetit ekonomik të vendit dhe zbatimit të ligjit. Besoj se me këtë projektbuxhet Ministria e Drejtësisë i ka marrë masat dhe për ata që ju mendoni se janë me slogane, që, nëse shkelin ligjin ne do t’i trajtojmë sipas të gjitha standardeve të Bashkimit Europian.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Mbaruan dhe pyetjet e kolegëve.

Zoti Fino, që është relatori do të bëjë përmbledhjen e diskutimeve dhe pyetje.

Bashkim Fino - Faleminderit!

Së pari, unë dua ta çliroj pak ministrin e Drejtësisë nga ideja që, meqenëse e ka votuar projektbuxhetin në qeveri, këtu në mbledhjen e komisionit ka artikuluar disa herë fjalën që është dakord me këtë buxhet, por po t’i jepet më shumë akoma edhe më shumë do

të japë . Kjo do të thotë se paska kapacitete për të realizuar në qoftë se Ministria e Financave dhe ne si komision mund t'i japim diçka më tepër Ministrisë së Drejtësisë për të ecur përpara. Kjo do të thotë që ju duhet të çliroheni, në qoftë se keni vërejtje dhe sugjerime prandaj është parlamenti organi më i lartë dhe ju e dini se jeni ministër drejtësie. Nuk do të thotë se çdo projektligj që kalon nga qeveria mund të kalojë në mënyrë absolute ashtu në parlament. Parlamenti ka të gjitha instrumentet e nevojshme për të bërë korrigjimet e nevojshme, të cilat i shikon në kompleksitetin e të gjitha institucioneve të pavarura. Ta dhashë këtë mundësi dhe mund të jap një mundësi tjetër në qoftë se ju do të dëshironi të thoni disa gjëra në fund.

Por unë, zoti kryetar, doja të shprehja dy-tre shqetësime në lidhje me projektbuxhetin e Ministrisë së Drejtësisë krahasuar me Ministrinë e Financave. Do të ishte mirë t'i kisha ballë për ballë, se në krah të djathtë mund të mos dëgjojnë, se krah i djathtë gjithmonë nuk dëgjon, ndërsa ballë për ballë mund të dëgjojnë dhe mund të marrin ndonjë shënim. Që do të thotë se unë shikoj një ulje të shpenzimeve totale korrent të Ministrisë së Drejtësisë në raport me vitin e kaluar. Pra, në qoftë se buxheti i 2014-s jep 8 miliardë e 861 ose aktin normativ 8 miliardë e 034, apo faktikun 9- muhor, siç na ka ardhur këtu, unë i lexoj mirë shifrat, në 5,5 miliardë, propozimi është që shpenzimet e ministrisë do të jenë 7 miliardë e 087 milionë lekë. Pra, do të thotë që ka një minus prej 74 milionë lekësh. E para.

E dyta, ka një ulje të investimeve dhe kjo më shqetëson, pavarësisht se ministri tha këtu që nuk duam të bëjmë burgje të reja, por investimet në Ministrinë e Drejtësisë në totalin e saj që ka duhet të jenë gjithmonë në rritje, se është një nga ministritë më kryesore, të cilat ne duam të rrisim dhe kapacitetet që kemi, apo edhe nivelin e burgjeve tona. Zoti Ministër dhe zonja të nderuara të Ministrisë së Financave, qoftë sekretarja e Përgjithshme, qoftë drejtoresha e Përgjithshme, më rezulton që investimet në vitin 2014 kanë qenë 2 miliardë e 586 milionë lekë, ndërkohë që investimet që parashikohen për vitin 2015, flas gjithmonë për investime në total, është 1 miliard e 409 milionë lekë. Shikoj një ulje në investime me rreth 1 miliard e 277 milionë lekë dhe kjo më duket se vjen edhe si rezultat i rënies shumë të madhe të investimeve të huaja, të cilat nga 1 miliard e 767 shkon në 500. Për këto unë do të doja shpjegime nga Ministria e Financave se pse kur kemi një buxhet të konsoliduar, zoti kryetar, kur kemi një buxhet që kërkon dhe pretendon të rrisë 3% nivelin ekonomik, atëherë do të thotë se kjo përqindje e nivelit ekonomik dhe ulja e detyrimeve të borxhit do të thotë që në të gjithë strukturën e ministrive minimalisht parashikohet një 3% më shumë. Ndërkohë që në këta dy sektorë mua më del një ulje që nuk e justifikoj dot.

Nga ana tjetër kam dhe një koment në lidhje me numrin e punonjësve. Numri i punonjësve është, siç tha ministri, që në raport me vitin e kaluar kemi një shtesë prej 419 punonjësish, numri i punonjësve duhet shumë i saktë. Unë dua të di në këta 419 punonjës që i shtohen Ministrisë së Drejtësisë janë të gjithë në sistemin e burgjeve, apo janë të shtrirë brenda strukturës së ministrisë dhe ajo pastaj do të bëjë detajimin e nevojshëm të saj?

Nga ana tjetër, si ekonomist, zoti kryetar, më vjen keq ta them, por nuk e di sa do të më kuptojë Moza, a është pasqyruar kjo shtesë prej 419 vetash më shumë në paga dhe sigurime shoqërore, sepse po të bëj një krahasim të pagave të 2014-s me pagat e 2015-s, më rezulton thjesht një rritje prej 379 milionë lekësh. Më duket pak më pak se sa rritja e numrit të punonjësve që është 419 punonjës. Pra, do të thotë se duhet të bëhet një përlllogaritje e saktë, e drejtë, zoti ministër, por kjo nuk është në dorën tuaj, por në dorën e specialistëve të drejtorisë suaj të financës që të mos vijë fundi i vitit tjetër dhe të themi se fondi i pagave, vërtet e kemi numrin 419 më shumë, por nuk kemi mundësinë e fondit të pagave. Kjo duhet përlllogaritur.

Sugjerimi tjetër që kam, më rezulton vetëm në një pasqyrë këtu që në Ministrinë e Drejtësisë, në varësi të saj është dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Shifrat e kthimit të kompensimit të pronave, ka një korrigjim këtu, por shikoj një mospërputhje të madhe midis buxhetit të vitit 2014 aktual të kthimit të pronave që e ka rreth 1 miliard e 731 milionë lekë dhe projektbuxheti i vitit 2015 e ka 581 milionë lekë. Pra, diferenca është rreth 1 miliard e 150 milionë lekë. Dhe duhet që kjo diferencë, kur ne kërkojmë që t'i zgjidhim problemet e pronave, kur ne kërkojmë që të mbarojmë sa më shpejt qoftë legalizimet, qoftë kthimin e pronave, sepse për mua janë institucione transitore, të cilat do të vijë një moment që do të mbyllen, nuk mund të ngelen tërë jetën sa do të ekzistojë Ministria e Drejtësisë do të ekzistojë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo legalizimet. Atëherë pse ulim ne buxhetin e këtyre zyrave, ndërkohë që ne mund ta rrisim dhe të krijojmë hapësirën dhe mundësinë për të bërë një punë më efektive për ta mbyllur çështjen e kthimit të pronave? Këto çështje të cilat u mundova të bëhem unë paksa avokati i ministrit të Drejtësisë, prandaj i thashë që të çlirohet në fillim, do të doja një sqarim nga Ministria e Financave, e cila mund të bëjë disa korrigjime, sepse janë të pranueshme që mund të bësh. Është si të thuash institucioni më kryesor që ne mbulojmë si Komision i Ligjeve, pavarësisht se do të kemi dhe institucione të tjera kushtetuese, të cilat ne mund t'ia bëjmë propozim pastaj Komisionit të Ekonomisë për të bërë relacionin përfundimtar në drejtim të parlamentit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Po, zonja Prodani.

Geraldina Prodani – Përshëndetje!

Adresimi i zotit Fino është i drejtë në shifra, por jo në problematikë, për arsye se diferenca që ekziston është për sa i takon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, 1,6 miliardë, e cila është në tabelën historike dhe të të dhënave nga Ministria e Financave konsiston në të ardhurat e trashëguara të mbledhura nga ALUIZN-i

Ndërsa për sa i takon fondit, i cili do të jetë në dispozicion për të adresuar problemin e ish-pronarëve, ai do të ngelet po në të njëjtin nivel që ka qenë në vitin 2014 dhe konsiston në 1,4 miliardë. Në qoftë se do të heqim pikërisht këtë shifër, e cila është teknike buxheti i Ministrisë së Drejtësisë është në të njëjtin nivel sa viti 2014, por mos të harrojmë se ashtu sikurse tha zoti Fino, financimi i huaj ka qenë në nivelin 1,8 miliardë dhe konsiston pikërisht në përfundimin e burgjeve të cilët ne po mundohemi t'i vendosim në punë me buxhetin e vitit 2015, i cili e ka ulur totalin e Ministrisë së Drejtësisë. Por në total është njësoj me nivelin e vitit 2014, ndërsa investimet kanë ulje përkatësisht për uljen që ka ndodhur në financimin e huaj.

Për sa u takon pagave buxheti siguron jo vetëm shtesën, numrin e punonjësve, por gjithashtu edhe financimin me pagat dhe sigurime të gjithë punonjësve të cilët rekrutohen.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka komente të tjera? Nuk ka komente të tjera.

Gjithsesi do të ndjekim procedurën e zakonshme. Ne i regjistruam shqetësimet që u ngritën dhe pa dyshim dhe ndërhyrjet që u bënë nga kolegët dhe nga relatori. Ministria e Financave i mbajti shënim dhe në fund do të bëjmë debatin për të gjitha institucionet se çfarë mund të plotësojmë dhe në këtë kontekst desha të dija që ministria ka kërkuar që të ketë një shtesë të numrit për inspektorët. Kur të vijë momenti do të desha të kem një përgjigje nëse përfshihen në këtë shifër apo nuk përfshihen rritja e numrit të inspektorëve. Gjithsesi besoj se do ta mbajnë shënim zonjat e Ministrisë së Financave dhe kur të kalojmë një për një do të duhet të përgjigjen.

Geraldina Prodani - Në këtë buxhet janë shtuar 10 inspektorë në projektbuxhetin e vitit 2015 për këtë funksion.

Fatmir Xhafaj – E mbyllim këtu mbledhjen. Nesër do të takohemi në orën 10:00.
(Zoti Xhafaj i drejtohet një deputeti në sallë)

Nuk është ministri sot. Nesër do t'i mbledhim bashkë me ministrin e Brendshëm, meqenëse është gjendja civile dhe pushteti lokal.

Faleminderit, zoti Ministër! Faleminderit, zonja dhe zotërinj kolegë!

Nesër në orën 10 kemi ministrin e Brendshëm, pastaj Prokuroria e Përgjithshme pas Ministrisë së Brendshme. Më pas zyra e administrimit të buxhetit gjyqësor. Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk do të jetë se është dakord me çfarë është dhënë. Më në fund e kemi një të kënaqur në këtë shtet me paratë. Gjykata Kushtetuese dhe do ta mbyllim me bordin e Shkollës së Magjistraturës.

Nesër Ministria e Financave. Në orën 10: 00, zonja Prodani, zonja Dhëmbi, të jeni këtu!

Faleminderit të gjithëve!

MBLEDHJA MBYLLET